



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.116

10 nëntor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.702, datë 11.10.2006	Për miratimin e stemës së universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës	4629
Vendim i KM nr.703, datë 11.10.2006	Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve të veçuara, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare.....	4631
Vendim i KM nr.704, datë 11.10.2006	Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe për procedurën e shitjes.....	4634
Vendim i KM nr.708, datë 18.10.2006	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 2004.....	4650
Vendim i KM nr.709, datë 18.10.2006	Për miratimin e protokollit të bisedimeve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin, financiar e teknik, për vitin 2006.....	4651
Vendim i KM nr.710, datë 18.10.2006	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për bashkëpunim në fushën e energjisë.....	4659
Vendim i KM nr.712, datë 18.10.2006	Për krijimin, përbërjen, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të komitetit <i>ad-hoc</i> të lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve.....	4661
Vendim i KM nr.722, datë 25.10.2006	Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagës së papunësisë nga bashkëshorti/ja e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit.....	4663

VENDIM
Nr.702, datë 11.10.2006

PËR MIRATIMIN E STEMËS SË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, Durrës

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e stemës së universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, e cila të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

ELEMENTET PËRBËRËSE TË STEMËS SË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”


Stema është në formë rrethore. Ajo përmban tre rrathë ekocentrikë. Trashësia e vijës së dy rrathëve më të vegjël është e njëjtë dhe sa $1/3$ e trashësisë së rrethit më të madh. Distanca ndërmjet rrethit më të vogël dhe atij të mesit është 5 herë sa distanca midis rrethit më të madh dhe atij të mesit. Në fusha midis dy rrathëve më të vegjël është e ngjyrosur me gradient radial, që nis me ngjyrë portokalli dhe mbaron me ngjyrën e bardhë. Në pjesën e poshtme të kësaj hapësire, me germa të mëdha me llojin e germave “Trajan Pro”, madhësi 40 pt, stil bold dhe ngjyrë të zezë, shkruhet fjala:

Durrës,

ndërsa në pjesën e sipërme me të njëjtin stil shkruhen fjalët:

Universiteti “Aleksandër Moisiu”

Fusha e rrethit të vogël është e ngjyrosur me gradient linear me kënd 45 gradë, që nis me ngjyrën blu dhe mbaron me ngjyrën e bardhë. Në këtë fushë janë vendosur dy kolona antike vertikale dhe paralele me njëra-tjetrën mbi një libër të hapur, dhe që ndërpriten nga një e tretë, duke formuar imazhin e germës “U”. Kolona vertikale e djathtë pasohet nga një velë, e cila së bashku me kolonën e djathtë formon imazhin e germës “D”. Kolonat, libri dhe vela janë konturuar nga vija të zeza me hije portokalli. Libri dhe kolonat kanë ngjyrë të bardhë, ndërsa vela skajet i ka me gradient linear nga e zeza në të bardhë, ndërsa në mes ka një shirit me ngjyrë portokalli të çelët.



VENDIM
Nr.703, datë 11.10.2006

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË SHITJES SË TROJEVE TË
NDËRMARRJEVE SHETËTËRORE APO TË OBJEKTEVE TË VEÇUARA, QË I NËNSHTROHEN
PRIVATIZIMIT OSE TRANSFORMIMIT TË TYRE NË SHOQËRI TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E TRUALLIT

1. Ky vendim ka për objekt të përcaktojë kriteret dhe procedurat për vlerësimin dhe shitjen e truallit të ndërmarrjeve shetëtorë, që u nënshtrohen procedurave të privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare.

2. Procedurat e vlerësimit të truallit fillojnë me daljen e urdhrin të përfaqësuesit të pronarit shetëtor, për rastet që kanë të bëjnë me:

- a) privatizimin e ndërmarrjes ose të objekteve të veçanta, në zbatim të vendimit nr..., datë..., të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e vlerësimit të pronës shetëtorë, që privatizohet, dhe procedurën e shitjes".
- b) transformimin e ndërmarrjeve shetëtorë në shoqëri tregtare, sipas vendimit nr.194, datë 20.3.1998 të Këshillit të Ministrave.

II. PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË TRUALLIT TË NDËRMARRJEVE, QË PRIVATIZOHEN OSE TRANSFORMOHEN NË SHOQËRI TREGTARE

1. Me marrjen e urdhrin të përfaqësuesit të pronarit shetëtor, ndërmarrja krijon komisionin e vlerësimit, i cili brenda 15 ditëve përgatit:

- a) genplanin e ndërmarrjes apo të objekteve, që do të privatizohen, në zbatim të urdhrin të përfaqësuesit të pronarit, në pesë kopje origjinale;
- b) përshkrimin e ndërmarrjes dhe/ose objekteve të saj, sipas genplanit;
- c) përcaktimin e sipërfaqes së nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë, ku përcaktohet qartë sipërfaqja nën objekt dhe ajo funksionale.

2. Drejtoria e ndërmarrjes, pas marrjes nga komisioni i vlerësimit të dokumentacionit të mësipërm, së bashku me urdhrin përkatës të përfaqësuesit të pronarit shetëtor, i drejton organit të qeverisjes vendore, në juridiksionin e të cilit ndodhet objekti, kërkesën për:

- a) miratimin e genplanit, me sipërfaqen përkatëse, nga zyra e urbanistikës;
- b) aktin e konfirmimit të sipërfaqes së truallit të objektit që privatizohet;
- c) hartën treguese;
- ç) koeficientin e vendndodhjes së objektit.

3. Zyra e urbanistikës së organit të qeverisjes vendore, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës së ndërmarrjes, i kërkon zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të dhëna zyrtare për statusin e pronësisë së trojeve apo të objekteve të paluajtshme, që përfshihen në genplanin e hartuar nga ndërmarrja, dhe hartën treguese të këtyre pasurive të paluajtshme.

4. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, i dërgon zyrës së urbanistikës së organit përkatës të qeverisjes vendore, hartën treguese të pasurive të paluajtshme të zonës përkatëse, sipas kërkesës, së bashku me certifikatën e pronësisë, nëse ka një të tillë. Konfliktet për pronësinë e truallit zgjidhen në rrugë gjyqësore, para kryerjes së procedurave të vlerësimit.

5. Zyra e urbanistikës së organit të qeverisjes vendore, brenda 10 ditëve nga marrja e përgjigjes prej zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, saktëson genplanin përfundimtar, në pesë kopje origjinale, dërguar nga ndërmarrja, në bazë të dokumentacionit të siguruar si më sipër, ku përcaktohen sipërfaqja nën objekt, sipërfaqja funksionale dhe ajo e përgjithshme. Organi i qeverisjes vendore, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së ndërmarrjes, i përcjell kësaj të fundit, në pesë kopje origjinale, të nënshkruara dhe të vulosura:

- a) genplanin përfundimtar, të konfirmuar nga zyra e urbanistikës;
- b) aktin e konfirmimit të sipërfaqes së truallit të objektit, që privatizohet (sipërfaqen nën objekt, sipërfaqen funksionale dhe sipërfaqen e përgjithshme);
- c) hartën treguese;
- ç) koeficientin e vendndodhjes së objektit, sipas kategorizimit të zonës përkatëse.

6. Ndërmarrja, pas marrjes së dokumentacionit nga organi i qeverisjes vendore, vazhdon procedurat përkatëse, sipas urdhrin të përfaqësuesit të pronarit shetëtor.

7. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pas marrjes së dokumentacionit të vlerësimit, i

kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të përcaktojë çmimin e truallit të objektit, sipas hartës së çmimeve, të përcaktuara nga kjo Agjenci.

Në rast se zona nuk ekziston në hartën e çmimeve, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave përcakton çmimin e truallit në këtë zonë në zbatim të vendimit nr.183, datë 28.4.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e metodikës për vlerësimin e pronës së paluajtshme, që kompensohet, dhe asaj që do të shërbejë për kompensim”.

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i kthen përgjigje Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.

8. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me marrjen e çmimit të truallit nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, plotëson, përfundimisht, dokumentacionin e vlerësimit të objektit dhe ia përcjell Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike).

9. Për efekt të zbatimit të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” do të zbatohet çmimi i truallit i përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji.

III. PROCEDURAT E SHITJES SË TRUALLIT TË NDËRMARRJEVE, QË NUK MUND TË TRANSFORMOHEN NË SHOQËRI TREGTARE

1. Shitja e truallit të ndërmarrjeve ose objekteve, që do të privatizohen, bëhet nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), sipas përcaktimit në autorizimin e kalimit të pronësisë, të lëshuar për këtë qëllim, për ndërmarrjen ose objektin përkatës.

2. Sipërfaqja e domosdoshme për zhvillimin e veprimtarisë së ndërmarrjes ose e pjesëve të ndara të saj, përcaktohet në bazë të genplanit ekzistues të ndërmarrjes, duke i hequr kësaj sipërfaqeje pjesët e panevojshme për funksionimin e ndërmarrjes ose të objektit. Kjo sipërfaqe përcaktohet nga komisioni i vlerësimit në ndërmarrje dhe saktësohet e konfirmohet nga zyra e urbanistikës së organit përkatës të qeverisjes vendore. Kjo sipërfaqe miratohet edhe nga drejtoria e shoqërive publike, pranë administratës së prefektit. Këto organe mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë e sipërfaqes së konfirmuar.

3. Shitja e truallit është pjesë e kontratës së shitjes së ndërmarrjes ose objektit. Paga e truallit bëhet vetëm me lekë.

IV. PROCEDURAT E SHITJES SË TRUALLIT TË NDËRMARRJEVE DHE OBJEKTEVE, QË JANË PRIVATIZUAR

1. Shitja e truallit të pasitur të ndërmarrjeve dhe objekteve të privatizuara nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, me degët e saj në rrethe, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), si dhe nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të NB-ve, me degët e saj në rrethe, të bëhet në përputhje me këtë vendim sipas genplanit të dosjes së privatizimit. Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) të bëjë edhe shitjen e trojeve të ndërmarrjeve e objekteve të tjera shtetërore, të privatizuara para krijimit të këtyre agjencive.

2. Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) u kërkon të dhëna, me shkrim, për pronësinë e truallit, çmimin e shitjes, sipas pikës 7 të kapitullit II të këtij vendimi, si dhe hartën treguese të objektit, përkatësisht, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat duhet të kthejnë përgjigje brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Kur nga të dhënat konfirmohet se:

a) trualli i objekteve të shitura ka pronar, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) kryen shitjen e truallit dhe lidhjen e kontratës. Vlera e shitjes i kalon pronarit të truallit si kompensim;

b) trualli i objekteve të shitura ka pronar shtetin, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) kryen shitjen e truallit dhe lidhjen e kontratës. Vlera e truallit derdhet në Buxhetin e Shtetit.

3. Personi fizik dhe juridik, privat, i cili do të blejë truallin e ndërmarrjes ose të objekteve, që ka privatizuar më parë, paraqet në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), në dy kopje, këto dokumente:

a) kërkesën me shkrim për blerjen e truallit;

b) vërtetimin e hipotekës për objektin, që ka në pronësi, të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme jo më parë se 10 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, një kopje e të cilit duhet të jetë origjinale, si dhe hartën treguese të pasurive të paluajtshme në zonat përkatëse;

c) fotokopjen e noterizuar të kontratës së shitblerjes së objektit, lëshuar nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, ish-Agjencia Qendrore e Strukturimit dhe Privatizimit të NB-ve dhe nga degët e tyre në rrethe;

ç) fotokopjen e noterizuar të kontratës së shitblerjes së objektit, kur privatizimi është bërë para krijimit të këtyre agjencive;

d) deklaratën noteriale, origjinale, se nuk ka proces gjyqësor për objektin dhe truallin përkatës.

Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) brenda 7 ditëve nga

paraqitja e kërkesës së mësipërme, u dërgon organeve përkatëse të qeverisjes vendore dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të kapitullit IV të këtij vendimi, të shoqëruar me genplanin përkatës, sipas dosjes së privatizimit dhe u kërkon:

- a) vërtetimin se subjekti kërkuar e ka paguar qiranë e truallit deri në çastin e kërkesës së bërë nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike);
- b) miratimin e genplanit, me sipërfaqet përkatëse, nga zyra e urbanistikës;
- c) aktin e konfirmimit të sipërfaqes së truallit të objektit që privatizohet (sipërfaqen nën objekt, sipërfaqen funksionale dhe sipërfaqen e përgjithshme).

4. Zyra e urbanistikës së organit përkatës të qeverisjes vendore, brenda 7 ditëve pas marrjes së kërkesës nga Ministria e Financave, konfirmon genplanin përfundimtar, ku saktësohen sipërfaqja nën objekt, sipërfaqja funksionale dhe ajo e përgjithshme dhe i përcjell Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), të nënshkruar dhe të vulosur, dokumentacionin, i cili përmban:

- a) genplanin përfundimtar, të konfirmuar nga zyra e urbanistikës;
- b) aktin e konfirmimit të sipërfaqes së truallit të objektit që privatizohet;
- c) vërtetimin se subjekti kërkuar ka paguar qiranë e truallit.

Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) pas marrjes së dokumentacionit të nevojshëm nga organet e qeverisjes vendore, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe AKKP-ja, njofton kërkuar për t'u paraqitur pranë këtij institucioni, për të marrë autorizimin për pagesën e vlerës së truallit, pagesë e cila duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit. Pas kryerjes së pagesës së vlerës së truallit, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) lidh me blerësin kontratën e shitjes së truallit, sipas pikës 2 të kapitullit IV të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet shtesë për objektet e privatizuara, që dalin të tilla pas rimatjes së sipërfaqeve të trojeve të tyre brenda kufizimeve të përcaktuara nga hartat treguese, të lëshuara nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të vërtetuara, me procesverbal, nga komisioni i përbërë me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përfaqësues të zyrës së urbanistikës së organit të pushtetit vendor, në juridiksionin e të cilit ndodhet ky objekt, përfaqësues të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), do të shiten nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), në përputhje me ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, ligjin nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

6. Paga e truallit të ndërmarrjes ose objektit, që është privatizuar ose do të privatizohet, bëhet vetëm në lekë.

V. TË PËRGJITHSHME

1. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, organet e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim nuk do të zbatohet për rastet e vlerësimit të truallit të objekteve, dokumentacioni i të cilave, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndodhet në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), për të cilat:

- ka përfunduar pagesa për vlerën e plotë të shitjes së tyre;
- kanë filluar procedurat e shpalljes për shitje.

4. Vendimi nr.169, datë 13.3.2003 i Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare", si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.704, datë 11.10.2006

PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET, SI DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar,

me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. VLERËSIMI I ELEMENTEVE TË PASURISË DHE KOMPETENCAT

1. Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha ndërmarrjet apo objektet e veçuara, mjetet kryesore dhe mjetet e xhiros të ndërmarrjeve, të shoqërive tregtare dhe institucioneve, me kapital tërësisht shtetëror, për të cilat është dhënë miratimi i përfaqësuesit të pronës shtetërore, për fillimin e procedurave të privatizimit a të transformimit në shoqëri tregtare në formim e sipër.

2. Vlera aktuale minimale (VAM-i), për çdo element të pasurisë shtetërore, llogaritet duke korrigjuar vlerën kontabël të mbetur me indeksin mujor të çmimit dhe koeficientin e vendndodhjes, si më poshtë vijon:

a) Për ndërtesat dhe objektet ndërtimore, që figurojnë si njësi të veçanta të ndërmarrjes, vlera kontabël e mbetur të përcaktohet, duke zbritur nga vlera fillestare kontabël vlerën e amortizimit (kontabël), të llogaritur, në bazë të viteve të përdorimit dhe të normës vjetore të konsumit, që përcaktohen sipas vendimit nr.401, datë 23.10.1989, pjesa “Amortizimi për investimet”.

Përcaktimi i vlerës aktuale minimale bëhet nga grupi i ekspertëve vlerësues, të cilët kërkohen nga komisioni i vlerësimit dhe miratohen nga organi qendror ose pushteti vendor, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes, kur:

- Mungojnë të dhënat:

i) për vlerën fillestare të objektit sipas kontabilitetit;

ii) për vlerën fillestare kontabël të objektit të veçuar nga një tërësi me të dhënat e njohura;

iii) për rastet kur objekti ka dëmtime, mungesa dhe, njëkohësisht, i mungon vlera fillestare kontabël.

Në këto raste grupi i ekspertëve vlerësues përcakton vlerën fillestare, duke u bazuar në gjykimin teknik për gjendjen faktike të objektit, duke përdorur çmime të manualit, 1986-1990. Komisioni i vlerësimit miraton vlerën e përcaktuar nga ekspertët, ndërmjet situacionit apo raportit vlerësues dhe, pasi zbret amortizimin sipas kontabilitetit, përcakton vlerën aktuale minimale, duke zbatuar indeksin mujor të çmimit dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Mungon viti i vënies në shfrytëzim. Në këtë rast grupi i ekspertëve vlerësues përcakton amortizimin faktik, duke u bazuar në gjykimin teknik të gjendjes faktike të objektit. Komisioni i vlerësimit përcakton VAM-in duke zbatuar amortizimin faktik mbi vlerën fillestare kontabël indeksin mujor të çmimit dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Objekti ka dëmtime fizike apo mungesa pjesësh a instalimesh organike, që cenojnë funksionimin e tij. Ekspertët vlerësues përcaktojnë vlerën fillestare të mungesave apo të dëmtimeve, sipas manualit të çmimeve, 1986-1990. Komisioni i vlerësimit, pasi miraton vlerën e përcaktuar nga ekspertët, llogarit vlerën kontabël të mbetur, duke zbritur nga vlera fillestare kontabël e objektit vlerën fillestare të mungesave apo dëmtimeve e duke zbatuar amortizimin përkatës. VAM-i përcaktohet duke zbatuar indeksin e çmimit mujor, si dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Objekti i janë bërë ndreqje apo shtesa, të cilat nuk janë pasqyruar në kontabilitet. Në këtë rast, ekspertët vlerësues përcaktojnë vlerën faktike të tyre me çmimet e manualit, 1986-1990. Komisioni i vlerësimit, pasi miraton vlerën e përcaktuar nga ekspertët, llogarit vlerën kontabël të mbetur, duke i shtuar diferencën së vlerës fillestare kontabël me amortizimin përkatës të objektit, vlerën e këtyre ndreqjeve apo shtesave. VAM-i përcaktohet duke zbatuar indeksin e çmimit mujor, si dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Amortizimi kontabël është mbi 100 për qind, por objekti ka vlerë përdorimi. Ekspertët vlerësues përcaktojnë vlerën e amortizimit faktik, sipas gjykimin teknik për gjendjen reale të objektit. Komisioni i vlerësimit llogarit vlerën kontabël të mbetur, duke i zbritur vlerës fillestare kontabël amortizimin faktik të objektit. VAM-i përcaktohet duke zbatuar indeksin e çmimit mujor, si dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Objekti është shumë i dëmtuar dhe komisioni i vlerësimit gjykon se vlera e mungesave dhe e dëmtimeve të objektit nuk mund të llogaritet. Për këtë arsye komisioni i vlerësimit harton raportin e vlerësimit, të cilit i bashkëlidhen edhe fotografitë e objektit. Në këtë rast ekspertët llogarisin vlerën faktike të objektit, sipas gjykimin teknik për gjendjen reale të tij, nëpërmjet situacionit apo raportit të vlerësimit, duke përdorur manualin e çmimeve, 1986-1990, dhe duke zbatuar amortizimin, sipas kontabilitetit. Komisioni i vlerësimit përcakton VAM-in, duke zbatuar indeksin mujor të çmimit dhe koeficientin e vendndodhjes.

Për ndërtesat dhe objektet ndërtimore, të vëna në shfrytëzim apo të blera pas vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), vlera kontabël e mbetur të llogaritet sipas kreut I dhe mbi të të zbatohet koeficienti i indeksit të çmimeve, që del nga raporti ndërmjet dy indekseve (të periudhës së vlerësimit ndaj asaj të ndërtimit ose të vënies në shfrytëzim). Vlerësimi i ekspertëve bëhet duke përdorur çmimet e tregut. Dokumentacioni teknik i ekspertëve vlerësues përfshihet në dosjen e vlerësimit.

- Norma e amortizimit përcaktohet nga ekspertët vetëm në rastet kur ajo nuk është përcaktuar në vendimin nr.401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave.

- Në rastet e vlerësimit të dëmtimeve dhe të mungesave për objekte, të vëna në shfrytëzim apo të blera pas datës 1 korrik 1992, ekspertët të përdorin çmimin e vitit të blerjes ose të vënies në shfrytëzim të objektit.

b) Për ndërtimet në proces, të papërfshira në kontabilitet, vlera aktuale minimale përcaktohet sipas kreut I, duke pasur parasysh që:

i) vlera fillestare kontabël të llogaritet, në bazë të situacioneve, të pranuar për likuidim nga banka;

ii) për ndërtimet në proces, pas 1 korrikut 1992 e në vazhdim, vlera e punimeve, për çdo situacion të dorëzuar në bankë, të korrigohet:

- me raportin e indeksit të çmimit të periudhës së vlerësimit ndaj atij të përfundimit të punimeve;

- me shtesat ose pakësimet për vendndodhjen.

Në rastet kur vlera e investimit në proces është përfshirë në kontabilitet veprohet si në kreun I, pa llogaritur dëmtimet e mungesat.

c) Për vlerësimin e makinerive e të pajisjeve, të vëna në përdorim para vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), si dhe pas vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), VAM-i përcaktohet në të njëjtën mënyrë si në ndërtimet e përcaktuara në kreun I, por pa zbatuar koeficientin e vendndodhjes.

ç) Për vlerësimin e mjeteve të transportit, tokësor e detar, të vëna në përdorim para vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), VAM-i përcaktohet në të njëjtën mënyrë si në ndërtimet e përcaktuara në kreun I, por pa zbatuar koeficientin e vendndodhjes. Për mjetet e blera apo të vëna në shfrytëzim pas vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), VAM-i përcaktohet si për ndërtimet, sipas kreut I, por pa zbatuar indeksin e çmimit, apo raportin ndërmjet dy indekseve dhe koeficientit të vendndodhjes.

d) Për inventarin ekonomik, instrumentet dhe veglat e punës, si dhe për elemente të tjera, që figurojnë në përbërje të aktiveve të qëndrueshme (mjete kryesore) të ndërmarrjes, vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit, në bazë të vlerës kontabël të mbetur. Vlera kontabël e mbetur përcaktohet për çdo njësi inventari, duke zbritur nga vlera fillestare kontabël shumë e amortizimit, që i përgjigjet shkallës së konsumit, për shkak të përdorimit.

dh) Për kafshët e punës dhe të përdorimit të prodhimit dhe për gjënë e gjallë në rritje dhe majmëri, vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit, në bazë të çmimeve të tregut, duke mbajtur parasysh vlerën zooteknike.

e) Për kulturat drufrutore, ullinjë, vreshtat në prodhim ose në rritje, vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit, në bazë të llogaritjes së vlerës kontabël, të regjistruar, dhe duke zbritur, kur është rasti, amortizimet e pësuara.

Për rastet e mungesave ose të dëmtimeve, komisioni a grupi i ekspertëve vlerësues të veprojnë si në rastin për ndërtimet. Për këtë grup vlera e mbetur nuk indekssohet.

ë) Për vlerësimin e mjeteve të xhiros që janë gjendje në ndërmarrje, VAM-i përcaktohet në këtë mënyrë:

Komisioni i vlerësimit i ndan mjetet e xhiros në tre grupe:

- Grupi "a"- artikujt që kanë vlera tregtimi me qarkullim normal, vlerësohen me vlerën aktuale kontabël, duke i krahasuar me çmimet e shitjes me shumicë në tregun aktual.

- Grupi "b"- artikujt që kanë vlerë tregtimi, por me qarkullim të ngadalshëm, vlerësohen me vlerën kontabël të kohës së blerjes së artikullit apo të përgatitjes së produktit të gatshëm për shitje, duke i krahasuar me çmimet e shitjes me shumicë në tregun aktual.

- Grupi "c" - artikujt që nuk gjejnë treg shitjeje dhe nuk kanë vlerë aktuale si materiale, pjesë ndërrimi, që përdoren nga makineri e mjete transporti të hequra nga përdorimi, vlerësohen me vlerën kontabël të kohës, kur janë futur gjendje në ndërmarrje, të shumëzuar me koeficientin 0.1.

Kur ka elemente pasurie pa vlerë përdorimi apo të zhvlerësuar, nxirren jashtë përdorimit ose u ulen vlera. Nxjerrja jashtë përdorimit bëhet në përputhje me vendimin nr.170, datë 11.3.1985 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Ulja e vlerës bëhet nga komisioni i vlerësimit, me pjesëmarrjen e grupit të ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë dhe miratohet nga këshilli drejtues i ndërmarrjes.

Vlera e nxjerrë nga komisioni i vlerësimit ditën e mbylljes së vlerësimit, si pasojë e shumës së tri vlerave të sipërpërmendura, do të përfaqësojë vlerën aktuale minimale të mjeteve të xhiros në çastin e shitjes për ndërmarrjet me veprimtari të bllokuar në intervalin e kohës vlerësim-shitje. Për ndërmarrjet që vazhdojnë veprimtaritë gjatë intervalit vlerësim-shitje, blerjet pas vlerësimit të pasqyrohen në kartela të reja, kurse shitjet të pasqyrohen në kartelat ekzistuese. Në këtë rast i jepet e drejta likuidatorit që për artikujt e rinj të grupit "a", me grup ekspertësh, të bëjë vlerësimin e tyre, sipas çmimeve aktuale të tregut me shumicë. Për të tjerët qëndron në fuqi mënyra e sipërpërmendur e vlerësimit.

3. Indeksi i çmimeve, i publikuar nga INSTAT-i, do të zbatohet për muajin kur përcillet dokumentacioni i vlerësimit në degën e shoqërive publike.

4. Koeficienti i vendndodhjes, i cili përdoret vetëm për ndërtimet dhe objektet ndërtimore, duhet të konfirmohet nga zyra e urbanistikës në organet e qeverisjes vendore, ku ndodhet objekti. Tabela e përcaktimit të këtij koeficienti i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Vlerësimi i detyrimeve të ndihmave shtetërore, që krijojnë fond kundërparti, të bëhet sipas kritereve të vendimeve nr.465, datë 3.10.1994 dhe nr.55, datë 30.1.1995 të Këshillit të Ministrave, dhe të udhëzimit të Ministrisë së Financave, në zbatim të tyre. Këto do të pasqyrohen si zë më vete, pasi pagesa e tyre do të bëhet në lekë.

6. Për vlerësimin e aseteve në shoqëritë tregtare, si vlerë fillestare kontabël të vlerësohet vlera e regjistruar në aktin e vlerësimit të kapitalit të shoqërisë, në çastin e themelimit. Vlerësimi të kryhet sipas kreut I të këtij vendimi, por pa zbatuar koeficientin e vendndodhjes.

7. Dokumentacioni për vlerësimin e pronës shtetërore, që privatizohet, të përgatitet sipas pasqyrave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. DETYRIMET DEBITORE DHE KREDITORE

Detyrimet, debitore dhe kreditore, të ndërmarrjeve shtetërore, që privatizohen, mbyllen në çastin e ndryshimit të pronësisë. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore mban përgjegjësi për rritjen e debi-kredive nga data e shpalljes së ndryshimit të pronës shtetërore. Për detyrimet debitore dhe kreditore veprohet, si më poshtë vijon:

1. Kur bëhet privatizimi i të gjithë ndërmarrjes shtetërore, detyrimet, debitore dhe kreditore, i kalojnë shtetit. Organi qendror ose pushteti vendor, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes, ngarkojnë një punonjës të sistemit financiar, ose një profesionist të lirë, me një kontratë të posaçme për ndjekjen e arkëtimit, deri në 30 ditë nga data e dorëzimit të objektit. Këta kanë të drejtën e shpërblimit nga 5 deri në 10 për qind të shumave të arkëtuara, por jo më shumë se 12 paga bazë të përgjegjësit të financës në këshillin e qarkut ose të bashkisë. Ky shpërblim reduktohet deri në zero, në qoftë se nuk zbatohet kontrata. Kjo kontratë është e vlefshme deri në 3 muaj dhe pas kësaj veprohet në bazë të ligjit nr.8901, datë 23.5.2003 "Për falimentimin".

2. Kur bëhet privatizimi i pjesshëm i ndërmarrjes shtetërore, detyrimet, debitore dhe kreditore, të ndërmarrjes i kalojnë për ndjekje administratës për pjesën, që mbetet shtetërore.

3. Likuidimi i detyrimeve të mbetura, për fondin kundërparti të ndihmave shtetërore, bëhet sipas kritereve të vendimeve nr.465, datë 3.10.1994 e nr.55, datë 30.1.1995 të Këshillit të Ministrave, si dhe të udhëzimeve të Ministrisë së Financave, të nxjerra në zbatim të tyre.

III. PROCEDURA E SHITJES SË PRONËS SHTETËRORE

1. Në këtë vendim, pronë shtetërore vlerësohet çdo njësi prodhimi, shërbimi, pjesë e tyre, mjete lundrimi e mjete xhiroje, që janë vendosur të shiten si pasuri fizike, sipas përcaktimit në miratimin e privatizimit.

2. Privatizimi i këtyre objekteve do të bëhet nëpërmjet ankandit, si më poshtë vijon:

a) Kur në dokumentacionin e vlerësimit të objektit për privatizim është konfirmuar se objekti ndodhet në truallin e ish-pronarëve, shitja e objektit do të bëhet pa ankand dhe ish-pronarët e truallit, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, kanë të drejtën e parablerjes së objektit me vlerën fillestare.

b) Kur ish-pronari i truallit, pas njoftimit të bërë nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës) nuk ka paraqitur dokumentet e pronësisë deri në afatin e përcaktuar në njoftim, bëhet një njoftim i dytë në dy gazeta me tirazh të lartë, si dhe njoftohet pronari, duke i lënë një afat të ri prej 30 ditësh nga data e njoftimit të parë. Nëse edhe në këtë afat të dytë pronari nuk paraqitet, atëherë kryhet shitja e objektit dhe e truallit, me ankand, sipas procedurave të këtij vendimi. Vlera e truallit, e përcaktuar në dosjen e privatizimit, derdhet për llogari të AKKP-së, për të kompensuar pronarin.

c) Kur në dokumentacionin e vlerësimit të objektit për privatizim është konfirmuar se objekti, që privatizohet, nuk ndodhet në truallin e ish-pronarëve, objekti i nënshtrohet ankandit, sipas procedurave të këtij vendimi. Në rast se në datën e zhvillimit të ankandit paraqitet ish-pronari i truallit, me dokumentacionin ligjor, që vërteton pronësinë e truallit të objektit, atëherë ish-pronari gëzon të drejtën e parablerjes, me vlerë fillestare të objektit.

3. Për punonjësit, që i kanë pasur dhe i kanë në përdorim automjetet, makineritë, pajisjet dhe mjetet e punës, të cilat janë të panevojshme për zhvillimin e veprimtarisë dhe që propozohen të shiten të shkëputura nga objektet, kryhet shitja pa ankand.

Në këto raste, nëse punonjësit nuk paraqesin kërkesë për blerjen e tyre dhe vërtetimin se janë përdorues të automjetit, makinerisë, pajisjes dhe mjetit të punës, brenda afatit të botuar, këto objekte kalojnë në ankand.

4. Për objektet e shërbimit, stomatologjik dhe farmaceutik, për të cilat punonjësit specialistë kanë një kontratë qiraje për objektin, këta punonjës kanë të drejtën e parablerjes, sipas çmimit, të përcaktuar në ankand, nëse këto objekte dhe trualli nën objekt nuk kanë pronar truall. Destinacioni i këtyre objekteve nuk duhet të ndryshojë për pesë vjet.

5. Pasuritë e ndërmarrjeve prodhuese, të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteozë, mbi 500 m² i shiten në mënyrë të drejtpërdrejtë kontraktuesit nëse vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 150 për qind e vlerës së truallit, subjekti nuk ka detyrime ndaj shtetit dhe nuk janë në konflikt gjyqësor, civil, për detyrime ndaj të tretëve. Vlerësimi i investimeve të kryera përcaktohet sipas bilancit të vitit të fundit ushtrimor, të miratuar nga ekspertët. Me daljen e urdhrin për privatizim, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës u kërkon, përkatësisht, AKKP-së çmimin e shitjes së truallit në zonën përkatëse dhe ndërmarrjes hartën treguese, genplanin, e konfirmuar nga organi i qeverisjes vendore, si dhe bilancin e miratuar të vitit të fundit ushtrimor.

AKKP-ja dhe ndërmarrja duhet të përgjigjen brenda një afati 30-ditor. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pasi merr dokumentacionin e përcaktuar më lart, brenda 10 ditëve, krahason vlerën e truallit dhe vlerën e investimeve të kryera. Nëse vlera e investimeve të kryera është mbi 150 për qind e vlerës së truallit, njofton ndërmarrjen për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit. Afati i përgatitjes së dokumentacionit të vlerësimit nga ndërmarrja në këtë rast është 20 ditë.

6. Procedurat e botimit fillojnë pasi të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) dokumentet e vlerësimit të objektit. Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) e pranon dosjen e objektit, nëse ekziston dokumentacion i rregullt dhe nëse ai është shqyrtuar nga strukturat përkatëse, të përcaktuara në këtë vendim. Në të kundërt kërkohet plotësimi i dokumentacionit. Vlera e fillimit të ankandit do të jetë VAM-i, i përcaktuar sipas kreut I të këtij vendimi (mjete kryesore + mjete xhiroje + vlera e truallit). Ankandi zhvillohet vetëm për mjetet kryesore dhe vlera e mjeteve të xhiros të shtohet sipas inventarit fizik, në çastin e dorëzimit të objektit.

Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) pas pranimit të dokumenteve të vlerësimit të objektit, fillon botimin për privatizim, pas zbatimit të pikës 5 të kreut III të këtij vendimi, si më poshtë vijon:

- a) botimi në buletin shtetëror 4 herë, brenda 21 ditëve;
- b) botimi i listës së objekteve që do të privatizohen dhe shpallja në faqen e internetit të Ministrisë së Financave e të dhënave për këtë objekt;
- c) fillimisht, Ministria e Financave duhet të vendosë njoftim me afishe në mjediset ku do të organizohet zhvillimi i ankandit të tyre dhe në ndërmarrjet përkatëse për objektet që do të privatizohen.

Në njoftim duhet të përcaktohen të dhënat për:

- vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;
- emërtimin dhe vendndodhjen e objektit që privatizohet;
- vlerën fillestare të ankandit;
- sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nën objekt;
- pronarin e truallit nëse ka (emër mbiemër etj.).

Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës së tyre në Ministrinë e Financave, kanë të drejtë të studiojnë dokumentacionin e vlerësimit, që ndodhet i depozituar në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) dhe të njihen me gjendjen fizike të objektit.

7. Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) harton një procesverbal, i cili përmban kopjen e buletinit, datat kur janë botuar njoftimet dhe një kopje të njoftimit me afishe, si dhe e arkivon atë.

8. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar, pranë komisionit të ankandit, këtë dokumentacion:

- a) kërkesë me shkrim për blerjen e objektit;
- b) garancinë bankare (apo mandatpagese), që vërteton ngurtësimin 20 për qind të vlerës së fillimit të ankandit në lekë, e cila ngurtësohet për llogari të Ministrisë së Financave, detyrimisht, brenda afatit të pranimit të kërkesave.

9. Ish-pronari i truallit, së bashku me kërkesën për blerjen e ndërmarrjes ose të objektit, që shtrihet mbi tokën, ish-pronë e tij, duhet të paraqesë në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), përveç sa kërkohet në pikën 7 dhe vendimin përkatës të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, apo çdo dokument tjetër ligjor, të regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku përcaktohet se ai është pronar i tokës. Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), kur e sheh të nevojshme, kërkon konfirmimin e Zyrës së Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme. Kur sipërfaqja e tokës, pronë e ish-pronarëve, shtrihet në mbi 70 për qind të sipërfaqes së truallit në objekt të objektit, që privatizohet, e drejta e parablerjes shtrihet në të gjithë objektin. Kjo vlen edhe për rastet kur ka disa bashkëpronarë dhe ndërmjet tyre ka një marrëveshje të dokumentuar. Në rastet kur objektit i është ulur vlera e fillimit të ankandit, ish-pronari, për të gëzuar të drejtën e parablerjes, duhet të bëjë pagesën e plotë, sipas vlerës fillestare dhe jo sipas vlerës së ulur.

10. Kur për objektet e shpallura për shitje sipas procedurave të këtij vendimi, nuk paraqitet asnjë kërkesë për blerjen e tyre, atëherë Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) cakton një VAM tjetër, më të ulët, për të tërhequr kandidatët për privatizimin e objektit. Ulja e VAM-it të objekteve bëhet, si më poshtë vijon:

- a) për ndërmarrjet ose objektet, ulja e VAM-it të jetë deri në 30 për qind;
- b) për makineritë, pajisjet, inventarin ekonomik, mjetet e transportit e mjetet e xhiros, ulja e VAM-it të jetë deri 50 për qind.

Në këto raste objekti u nënshtrohet të gjitha procedurave të përcaktuara në këtë vendim. Për rastet kur

mbetet vetëm një blerës si në botimin me vlerë fillestare, ashtu edhe për rastin kur për objektin është botuar ulje e VAM-it, bëhet një njoftim i ri, në një gazetë kombëtare, për një periudhë 10-ditore nga ky njoftim, si dhe vendoset një njoftim me afishe, pranë mjediseve, ku do të kryhen procedurat e zhvillimit të ankandit dhe, pas këtij botimi, Ministria e Financave realizon shitjen e objektit.

11. Për objektet, që mbeten pa u shitur edhe pasi është vepruar sipas pikës 10 të këtij vendimi, kalohet në shitjen me rezervë, nëpërmjet shitjes me këste, me afat kohor deri 5 vjet për objektet dhe deri 2 vjet për makineritë, pajisjet dhe mjetet e transportit etj. Vlera e shitjes, në këto raste, është ajo e VAM-it fillestar. Shitja me rezervë bëhet me ankand të hapur. Kriteri bazë për fituesit e ankandit është shlyerja e çmimit të shitjes, në afatin më të shkurtër kohor. Kur blerësit ofrojnë afate kohore të njëjta, komisioni i ankandit fikson këtë afat shlyerjeje të vlerës së objektit dhe kalon në zhvillimin e ankandit mbi vlerën e botuar të objektit.

Përcaktimi i kësteve dhe vlerat përkatëse të çdo kësti parashikohen nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) në kontratën e shitjes.

Ish-pronarët e truallit gëzojnë të drejtën e parablerjes sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij kreu, por gjithmonë sipas vlerës fillestare të objektit dhe me afat shlyerjeje 30 ditë.

12. Procedurat e botimit për shitjen me rezervë fillojnë nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), menjëherë pas përfundimit të ankandit, të kryer sipas pikës 10 të këtij kreu. Botimi bëhet sipas pikës 5 të këtij kreu dhe me të njëjtat të dhëna, duke shtuar formën e shitjes me rezervë.

13. Procedurat për rastet e parashikuara në pikat 10, 11 e 12 fillojnë me urdhër të përfaqësuesit të Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike). Çdo rregull shtesë do të jetë pjesë e botimit.

Për objektet, të cilat kanë kaluar të gjitha fazat e shitjes dhe për to nuk është realizuar shitja e tyre, dokumentacioni i vlerësimit të objektit kthehet nga Ministria e Financave në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 3 muajve nga zhvillimi i fazës së fundit të shitjes. Në rast se gjatë kësaj periudhe ka kërkesë, me shkrim, për blerje të objektit, përsëritet procedura e fazës së fundit të shitjes.

14. Përbërja e komisionit të ankandit është si më poshtë vijon:

- | | |
|--|----------|
| - Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave | kryetar; |
| - Përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës | anëtar; |
| - Përfaqësuesi i organit, që ka në administrim objektin | anëtar. |

Anëtarët e komisionit të ankandit duhet të pajisen me autorizimin përkatës dhe pjesëmarrja e tyre në datën dhe orën e caktuar për ankand është e detyrueshme.

Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- Të regjistrojë dhe të vërtetojë identitetin e pjesëmarrësve në ankand sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose me prokurë të veçantë përfaqësimi.
- Të paraqesë anëtarët e komisionit të ankandit.
- Të deklarojë vlerën fillestare të ankandit.
- Të deklarojë hapin e dhënieve të ofertave mbi vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand.
- Të drejtojë marrjen e ofertave.
- Të shpallë personin e fundit, që deklaroi çmimin më të lartë, si fitues i ankandit.
- Të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera përpara shpalljes së fituesit.

Procesverbali i ankandit është i detyrueshëm për t'u nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe pjesëmarrësit në ankand.

15. Pjesëmarrësve të tjerë në ankand (përveç fituesit) u kthehet 20 për qind e vlerës fillestare, të ngurtësuar paraprakisht. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, i konfiskohet 20 për qind e garancisë bankare të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

16. Personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nëpërmjet ankandit ose me të drejtën e parablerjes nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), pajiset me autorizim për kalim pronësie. Në këtë autorizim duhet të jenë përcaktuar qartë detyrimet e blerësit.

17. Brenda 30 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, blerësi është i detyruar të bëjë pagesën në lekë për pjesën e mbetur të çmimit të arritur në ankand.

18. Të ardhurat nga vlera e shitjes së objektit ndahen, si më poshtë vijon:

- 5 për qind e vlerës së shitjes Ministrisë së Financave;
- 5 për qind Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- 90 për qind Buxhetit të Shtetit.

19. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nuk paguan pjesën e mbetur të çmimit të arritur në ankand, brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes si pronar toke ose fitues ankandi, ai humbet të drejtën e blerjes. Pjesa 20 për qind, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand, nuk i kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar të gjitha procedurat e botimit, sipas këtij vendimi.

20. Pas pagesës së vlerës së plotë të objektit, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) është e detyruar të lidhë kontratën e shitjes me palën shitëse (përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, drejtori i ndërmarrjes për dorëzimin e pronës, blerësi privat). Afati i lidhjes së kontratës duhet të jetë jo më shumë se 60 ditë nga data e kryerjes së pagesës.

Dorëzimi i objektit bëhet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe drejtori i ndërmarrjes, në prani të blerësit, prania e të cilëve është e detyrueshme.

21. Nuk lejohen dhënia me qira dhe kalimi kapital i objekteve, të cilat janë shpallur për shitje.

22. Për objektet ndërtimore, të cilat nuk janë shitur edhe pasi janë zbatuar të gjitha fazat e shitjes, veprohet sipas vendimit nr.197, datë 20.3.1998 të Këshillit të Ministrave “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve, që nuk ka qenë e mundur të shiten”.

Për makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros, inventar ekonomik, të cilat nuk janë shitur edhe pasi janë zbatuar të gjitha fazat e shitjes, veprohet sipas vendimit nr.70, datë 11.3.1985 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave, materiale e monetare”, të ndryshuar.

23. Për shitjet e bëra nga Ministria e Financave njoftohet, me një evidencë statistikore, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në datën 20 të çdo muaji. Një kopje e kontratës së shitjes së çdo objekti ndërtimor i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare).

IV. DETYRAT DHE TË DREJTAT PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI

1. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore miratohet nga drejtuesi i institucionit ose i ndërmarrjes, ku kryhet vlerësimi i pasurisë shtetërore. Komisioni duhet të ketë jo më pak se tre anëtarë, njëri prej të cilëve duhet të jetë kryetari i degës së financës ose përgjegjësi i llogarisë së ndërmarrjes dhe të kryesohet nga drejtori ose zëvendësi i tij.

2. Komisioni i vlerësimit, për rastet e përcaktuara në këtë vendim, kërkon të miratohen ekspertët vlerësues. Këta ekspertë, sipas kërkesës së ndërmarrjes a institucionit, miratohen nga titullari i organit administrativ ose pushtetit vendor, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes. Numri i ekspertëve duhet të jetë jo më pak se dy dhe ata duhet të jenë ekspertë të fushës përkatëse të vlerësimit, që do të kryejnë. Komisioni i vlerësimit dhe ekspertët vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë e vlerësimit, që kryejnë, dhe për hartimin e dokumentacionit të nënshkruar prej tyre (akte vlerësuese, situacione etj.).

3. Anëtarët e komisionit, për periudhën e vlerësimit të pronës shtetërore, përfitojnë një pagesë suplementare mbi pagën bazë. Shpenzimet për këto pagesa kryhen dhe evidencohen nga institucioni, që kryen vlerësimin e pasurisë. Masa e shpërblyerit për ekspertët e vlerësimit të pasurisë shtetërore të jetë, si më poshtë vijon:

a) Anëtarët e komisionit, punonjës të ndërmarrjes, përfitojnë një shtesë 20 për qind mbi pagën bazë. Këtë masë shpërblyerit e përfiton edhe drejtori i ndërmarrjes, pavarësisht nëse është anëtar i këtij komisioni.

b) Ekspertët vlerësues të pasurisë shtetërore përfitojnë një shtesë 50 për qind mbi pagën bazë, për ditët e pjesëmarrjes në vlerësim. Kur ekspertët janë profesionistë të lirë, pagesa e tyre është 1000 (një mijë) lekë për ditë pune. Ditët e nevojshme për ekspertim përcaktohen nga drejtuesi i ndërmarrjes.

4. Afati i plotësimit të dokumentacionit të vlerësimit për ndërtesat dhe ndërtimet, linjat e prodhimit dhe të shërbimit, duhet të jetë jo më shumë se 40 ditë nga data e mbërritjes në ndërmarrje ose institucion, të miratimit të privatizimit, ndërsa për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit etj., afati duhet të jetë jo më shumë se 20 ditë. Ky afat të përcaktohet, për çdo rast konkret, në urdhrin për ngritjen e komisionit të vlerësimit, dhe përfundimi i tij të jetë deri në datën e dërgimit të dokumentacionit të vlerësimit të pasurisë nga ndërmarrja ose institucioni në degën e shoqërisë publike përkatëse. Respektimi i këtij afati kontrollohet nga organi përkatës i varësisë administrative. Ngritja e komisionit të vlerësimit për objektet ndërtimore, të cilat kanë qenë në administrim të një subjekti, që nuk ekziston më, të bëhet nga organi i varësisë administrative të tij dhe, për rastet kur nuk ekziston as kjo strukturë, komisioni i vlerësimit ngrihet, sipas përcaktimit të përfaqësuesit të pronarit të pronës publike, në miratimin e privatizimit përkatës.

5. Dokumentacioni, i përgatitur nga komisioni i vlerësimit, dërgohet për kontroll në degën e shoqërive publike përkatëse. Kur pas kontrollit nga dega e shoqërisë publike, ky dokumentacion rezulton i rregullt, në përputhje me legjislacionin e privatizimit, dokumentacioni i përcillet brenda 20 ditëve:

- organit të varësisë administrative për objektet ndërtimore dhe linjat e prodhimit ose të shërbimit;

- Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, inventarin ekonomik e mjetet e xhiros etj.

6. Kur dokumentacioni i kontrolluar nga organi i varësisë administrative, pas kontrollit të ushtruar, rezulton i rregullt, ai përcillet, brenda 15 ditësh, në organin, që mban tagret e përfaqësuesit të pronës shtetërore.

7. Dokumentacioni i kontrolluar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kur gjendet në përputhje me legjislacionin e privatizimit, përcillet në Ministrinë e Financave.

8. Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe drejtori i ndërmarrjes janë të detyruar të përfundojnë dorëzimin, me procesverbal të objektit, që privatizohet, brenda 35 ditëve nga data e dhënies së autorizimit blerësit nga Ministria e Financave.

Drejtori i ndërmarrjes është përgjegjës për dorëzimin e pronës të blerësi. Për diferencat fizike, të lindura ndërmjet periudhës së vlerësimit dhe dorëzimit të objektit ose ndërmarrjes mbahet një procesverbal në prani të drejtorit të ndërmarrjes, ku evidencohen diferencat fizike dhe arsyet e krijimit, nxirren përgjegjësitë, kërkohet zhdëmtimi i tyre dhe bëhet kallëzimi sipas legjislacionit në fuqi. Procesverbali i dorëzimit nënshkruhet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, drejtori i ndërmarrjes e fituesi i së drejtës së blerjes së objektit dhe shërben si akt dorëzim i pasurisë.

Pas pagesës së plotë të vlerës së objektit, lidhet kontrata e shitjes, e cila nënshkruhet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave (Drejtori i Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), drejtori i ndërmarrjes për dorëzimin e pronës dhe fituesi i së drejtës së blerjes. Për rastet kur ka vështirësi në dorëzimin e objektit, afati 35-ditor i dorëzimit zgjatet, me autorizimin e përfaqësuesit të Ministrisë së Financave. Për rastet kur për blerjen e objektit janë shpallur fitues (bashkëpronarë) me të drejtën e parablerjes apo të ankandit dhe në çastin e nënshkrimit të kontratës njëri nga bashkëpronarët refuzon nënshkrimin e kontratës së shitjes, atëherë zbatohen dispozitat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

9. Procesverbali i nënshkruar dorëzohet, brenda afatit 35-ditor, në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike). Ministria e Financave i kthen vlerën e munguar blerësit, duke u bazuar në diferencat e përligjura, të evidencuara me procesverbalet përkatëse. Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe drejtori i ndërmarrjes, që privatizohet, kanë të drejtë të marrin specialistë ekspertë për dorëzimin e pronës shtetërore, kur ndërmarrja e ka vazhduar veprimtarinë dhe kur vërehen mungesa fizike në njësinë e inventarit. Gjatë procesit të dorëzimit, çdo blerës ka të drejtë të marrë pjesë ose të autorizojë një përfaqësues.

Kur blerësi e ka fituar të drejtën e blerjes së pronës shtetërore nëpërmjet ankandit dhe ka diferenca në dorëzimin e objektit, vlera e kthimit të diferencave do të jetë vlera e mungesave fizike, të rezultuara sipas VAM-it, shumëzuar me masën e rritjes së vlerës së ankandit në krahasim me vlerën fillestare të ankandit për objektin e shitur. Blerësit i kthehet kjo vlerë, me urdhër të Ministrit të Financave.

10. Për kontratat e shitjes, të deklaruara të pavlefshme, me vendim gjykate të formës së prerë, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme, Ministria e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) kthen dosjen e vlerësimit të objektit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për fillimin e rivlerësimit të objektit, sipas legjislacionit në fuqi për privatizimin. Ngritja e komisionit të vlerësimit për objektet ndërtimore, të cilat kanë qenë në administrim të një subjekti, që nuk ekziston më, bëhet nga organi i varësisë administrative të tij dhe, për rastet kur nuk ekziston as kjo strukturë, ky komision ngrihet, sipas përcaktimit të përfaqësuesit të pronarit të pronës publike, në miratimin e privatizimit përkatës.

11. Vendimi nr.159, datë 13.3.2003 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, si dhe procedura e shitjes”, të ndryshuar, si dhe udhëzimet, në zbatim të tyre, shfuqizohen.

12. Në zbatim të këtij vendimi nuk do të përfshihen:

a) procedurat e vlerësimit për dokumentacionin e objekteve që janë dërguar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa për procedurat e shitjes do të zbatohet ky vendim;

b) praktikat që ndodhen në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), të cilat:

i) kanë përfunduar pagesën për vlerën e plotë të shitjes së tyre;

ii) kanë filluar procedurat e botimit deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

13. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave të hartojnë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NDËRMARRJE
INSTITUCION
OBJEKTI

Pasqyra nr.1

Gjendja faktike e mjeteve kryesore dhe vlerësimi i tyre në kohën e përfundimit të vlerësimit

Nr.	Emërtimi	Vl.fillestare e ndërtim prodhimit apo çmimi i blerë sipas kontabilitetit ose vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit 000/lekë	Amortizimi për investimet në 000/lekë	Vlera e mbetur në 000/lekë		Vlehtë e korrigjuar me indeksin e çmimeve	Vlera e korrigjuar me koeficientin e vendndodhjes	Sipërfaqja m ²	
				V.fillestare minus amortizimin sipas kontabilitetit	Vlehtë e llogaritur me grup ekspertësh			Gjithsej	Nga kjo nën objekti
	a	b	c	ç	d	e	f	g	
1	Ndërtesa gjithsej								
2	Instal.pajisje transmesioni								
3	Makineri e pajisje energjetike								
4	Makineri e pajisje pune								
5	Instrumenta e vegla								
6	Mjete transporti								
7	Kafshë pune e prodhimi								
8	Kultura drufrutore								
9	Inventar ekonomik								
10	Të tjera								
	Shuma:								
11	Vlehtë e tokës								
	Totali:								

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Shënim: Kjo pasqyrë plotësohet nga Komisioni i vlerësimit duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës kontabël, llogaritjet e matjet e kryera prej tij në bazë të legjislacionit në fuqi, si dhe dokumenteve e procesverbaleve të tjera që shërbejnë për këtë qëllim.

NDËRMARRJA _____
INSTITUCIONI _____
OBJEKTI _____

Pasqyra nr.2

Gjendja faktike dhe vlerësimi për çdo objekt në kohën e përfundimit të vlerësimit

Emërtimi	Viti I		Vl.fillestare e prodhimit apo çmimit të blerjes sipas kontabilitetit ose vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit 000/lekë	Amortizimi sipas kontabilitetit për investimet në 000/lekë	Vlefte e mbetur në 000/lekë		Vlefte e llogaritur me koeficientin e çmimeve	Vlefte e llogaritur me koeficientin e vendndodhjes	Sipërfaqja m ²	
	Ndërtimit, prodhimit ose blerjes	Vënies në shfrytëzim			Vlefte fillestare minus amortizimin sipas kontabilitetit	Vlefte e llogaritur me grup ekspertësh			Gjithsej	Nga kjo nën objekt
a	b	c	ç	d	e	f	g	m	o	q
I.Vlefte e objektit										
Nga këto:										
1.Mjete kryesore										
a)Ndërtim montime										
b)Makineri pajisje										
c)Inventar ekonomik										
ç)Të tjera										
2.Mjete xhiro										
3.Toka										
Shuma										

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Shënim: Pasqyra plotësohet nga komisioni i vlerësimit mbështetur në dokumentacionin përkatës kontabël, llogaritjet e matjet e kryera prej tij në bazë të legjislacionit në fuqi, si dhe dokumenteve e procesverbaleve të tjera që shërbejnë për këtë qëllim.

NDËRMARRJA _____
 INSTITUCIONI _____
 OBJEKTI _____

Pasqyra nr.3

Gjendja faktike dhe vlerësimi i mjeteve të xhiros pa likuiditetet në kohën e përfundimit të vlerësimit

Nr.	Emërtimi	Grupi A	Grupi B	Grupi C
		Me vlerë aktuale kontabël jo më shumë se vlera në tregun aktual	Me vlerë kontabël në kohën e blerjes jo më shumë se vlera në tregun aktual	Me vlerë kontabël x koeficientin 0.1
	a	b	c	d

1. Lëndë të para e materiale kryesore
2. Materiale ndihmëse
3. Lëndë djegëse
4. Pjesë ndërrimi
5. Ambalazhe
6. Inventar i imët në depo
7. Inventar i imët në përdorim
8. Prodhim në proces
9. Produkte të gatshme në magazinë
10. Mallra

Shuma gjithsej: _____

Nga kjo:

- a) Stoque
- b) Me qarkullim të ngadalshëm

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Shënim: Kjo pasqyrë plotësohet bazuar në llogaritë analitike të mjeteve xhiruese, dokumenteve e procesverbaleve përkatëse kontabël, inventarizimit fizik për çdo element të tyre, si dhe rivlerësimit me çmimet e liberalizuara të tregut të lirë duke e grupuar sipas pasqyrës së mësipërme.

NDËRMARRJA _____

INSTITUCIONI _____
OBJEKTI _____

Pasqyra nr.4

Gjendja financiare e ndërmarrjes ose institucionit që privatizohet në kohën e përfundimit të vlerësimit

Të ardhurat			Detyrimet		
Nr.	Emërtimi i llogarive	Vlefta 000/lekë	Nr.	Emërtimi i llogarive	Vlefta 000/lekë
	Shuma			Shuma	

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

NDËRMARRJA _____
INSTITUCIONI _____
OBJEKTI _____

Gjendja faktike dhe vlerësimi i investimeve në proces, në momentin e përfundimit të vlerësimit

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Vlefte fillestare e ndërtimit, prodhimit apo çmimi i blerjes sipas situacionit e dokumenteve të tjera kontabël		Vlefte e shitjes e llogaritur me koeficientin e vendndodhjes	Sipërfaqja	
		Para korrigjimit	Pas korrigjimit me ind.e çmimit		Gjithsej	Nën objekt
	a	b	c (b x indx)	ç (c+shtes)	d	e

I. Vlefte gjithsej

Nga këto:

1. Ndërtim montime
2. Makineri pajisje
3. Investime të tjera
4. Studime
5. Mjete xhiruese pranë objektit
6. Vlefte e tokës

Shuma: _____

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Shënim: Të dhënat për plotësimin e kësaj pasqyre të merren nga situacioni i ndërtimit të objektit të dokumenteve e procesverbaleve përkatëse kontabël, që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve, si dhe llogaritjen e matjet e bëra direkt nga komisioni i vlerësimit. Kolonat "C" tregon vlerën fillestare të korrigjuar me indeksin e çmimeve të konsumit.

NDËRMARRJA _____
INSTITUCIONI _____
OBJEKTI _____

Të dhënat ekonomiko-financiare të ndërmarrjes ose institucionit që privatizohet

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Vitet		
			Paraardhës	Ekzistues	Parashikues
1	Sipërfaqja e objektit dhe ambienteve që disponon ndërmarrja	m ²			
2	Sipërfaqja e tokës e punuar	m ²			
3	Vëllimi i prodhimit industrial i shitur	000/lekë			
4	Vëllimi i prodhimit bujqësor	000/lekë			
5	Volumi i punimeve të SMT	000/lekë			
6	Volum i riparim - shërbimeve, meremetimeve	000/lekë			
7	Volumi i transportit të mallrave	000/lekë			
8	Volumi i ndërtim montimeve	000/lekë			
9	Qarkullimi i mallrave gjithsej	000/lekë			
10	Vëllimi i investimeve	000/lekë			
11	Importi gjithsej (çmimi i blerjes)	000/lekë			
12	Eksporti gjithsej (çmimi i shitjes)	000/lekë			
13	Numri i punonjësve	Nr.			
14	Fondi i pagave	000/lekë			
15	Fitimi gjithsej	000/lekë			
	Nga ky: I derdhur në buxhet				
16	Humbje gjithsej	000/lekë			
17	Gjendje financiare	000/lekë			

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

NDËRMARRJA _____
 INSTITUCIONI _____
 OBJEKTI _____

Disa tregues përmbledhës të ndërmarrjes ose të institucionit që do të privatizohet

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Në kohën e përfundimit të vlerësimit	Vërejtjet
1	Vlefë e shitjes së mjeteve kryesore	000/lekë		
2	Vlefë e shitjes së mjeteve xhiruese	000/lekë		
3	Vlefë e shitjes së investimeve në proces	000/lekë		
4	Shuma 1- 2 – 3			
5	Fitimi për një punonjës			
6	Humbja për një punonjës			
7	Kërkesat e paraqitura për privatizim			
	Nga këto:			
	- Blerje direkte			
	- Aksione			
	- Ankand			
8	Vlera e shitjes ose e dhënies me qira të tokës			

Komisioni i vlerësimit

() () () ()

Vendndodhja e objekteve të paluajtshme	Shtesa	Pakësime
a) Në rrethet ose qytetet: Tiranë, Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Vlorë ose në qendrat e banuara turistike, ku përfshihen zonat e përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.88, datë 1.3.1993 “Për miratimin e zonave që kanë përparësi në zhvillimin e turizmit”		

- Zonat e thella malore joturistike	-	30%
- Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a)	15%	-
- Brenda vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a), përveç pjesëve që përfshihen në poshtë	50%	-
- Në rrugët kryesore dhe segmente rrugësh me trafik të dendur (RRKSTD) të qyteteve: Fier, Lushnjë, Berat, qendrat e banuara të përshkrura në pikën a.	60%	-
- Në RRKSRTD të qyteteve: Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Pogradec, Sarandë	70%	-
b) Në rrethet ose qytetet: Delvinë, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Laç e Lezhë		
- Në zonat e thella malore joturistike	-	50%
- Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika b)	-	-
- Brenda vijave kufizuese të qyteteve (pika b)	35%	-
- RRKSRTD të qyteteve të pikës b	50%	-
c) Në rrethet ose qytetet e Devollit, Kolonjës, Mallakastrës, Peqinit, Tepelenës, Peshkopisë, Kukësit, Përmetit dhe qytetet e qendrat e tjera me 10-20 mijë banorë		
- Në zonat e thella malore joturistike	-	55%
- Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c)	-	20%
- Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c)	-	-
- RRKSRTD në qytetet e qendrat (pikës c)	10%	-
d) Në rrethet ose qytetet: Bulqizë, Gramsh, Has, Kuçovë, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tropojë e qendra të tjera nën 10 000 banorë		
- Në zonat e thella malore joturistike	-	70%
- Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d)	-	25%
- Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d)	-	20%
- RRKSRTD në qytet e qendra (pika d)	-	15%
e) Në zonat e pikave doganore	35%	-

VENDIM
Nr.708, datë 18.10.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 2004

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i

Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 2004, për projektin “Shërbimi i studimit dhe i ekspertëve, VI”, me një fond grant 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) euro.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR, 2004

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 2 dhjetor 2004 në Tiranë,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/ose marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vlerë prej gjithsej 1 200 000,-- EUR (me fjalë: një milion e dyqind mijë euro) për krijimin e “Fondit të studimeve dhe të specialistëve VI”.

U konstatua se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, si projekt i mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose si fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose si masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose si masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëdihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësit të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvlehtësohet në rast se kontratat përkatëse për financim nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2012.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktues është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më datën 12.9.2006 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.709, datë 18.10.2006

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN, FINANCIAR E TEKNIK, PËR VITIN 2006

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të bisedimeve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin, financiar e teknik, për vitin 2006.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLLI I REZULTATEVE TË BISEDIMEVE QEVERITARE **MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR DHE TEKNIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS** **FEDERALE GJERMANE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR** **VITIN 2006**

Nga data 11 deri më 12 shtator u zhvilluan bisedimet qeveritare mbi bashkëpunimin financiar dhe teknik për vitin 2006 ndërmjet delegacionit të Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe delegacionit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në Tiranë.

Delegacioni gjerman kryesohej nga zoti Dr.Klemens van de Sand, Drejtor i Nëndrejtorisë në Ministrinë Federale për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik. Kryetari i delegacionit shqiptar ishte zëvendësministri i Ekonomisë, zoti Enno Bozdo.

Lista e anëtarëve të dy delegacioneve është bashkëngjitur si shtojcë.

Zëvendësministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, zoti Enno Bozdo, kryetari i delegacionit shqiptar përshëndeti miqtë gjermanë dhe i falenderoi ata për ndihmën që Qeveria Gjermane i ka dhënë dhe i jep Qeverisë Shqiptare në kuadër të procesit të integritetit evropian. Ky bashkëpunim ka filluar me marrëveshjen në kuadër të datës 21.10.1988 duke vazhduar më pas me një sërë marrëveshesh të tjera, duke përfshirë fusha të ndryshme të bashkëpunimit dypalësh. Gjithashtu vlerësohet edhe prania e firmave prestigjioze gjermane si “Siemens”, “Mercedes Benz”, “Volkswagen”, “Hochtief usw”. Gjithashtu u theksua fakti se Qeveria Shqiptare është angazhuar në reforma afatgjata dhe të qëndrueshme për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, për krijimin e një mjedisi të ri dhe atraktiv për zhvillimin e biznesit. Të rëndësishme janë në këtë kontekst zbatimi i ligjit, rritja e transparencës, thjeshtëzimi i sistemit doganor, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, zgjidhja e çështjeve të pronësisë mbi tokën, përmirësimi i stabilitetit politik në vend dhe në rajon. Një kontribut të veçantë në përfortimin e bashkëpunimit dypalësh ka dhënë edhe vizita e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, zotit Genc Ruli, në Gjermani.

I ngarkuari me punë i Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë, zoti J.Beissert, vlerësoi bashkëpunimin gjermano-shqiptar për zhvillim si një sukses të madh dhe theksoi rolin e tij të rëndësishëm në përmirësimin e objektivave për zhvillim të mijëvjeçarit. Ai përshëndeti përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të përmirësuar koordinimin e donatorëve të ndryshëm, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar të planifikimit. Krijimi i kushteve tërheqëse për investime direkte është i një rëndësie të madhe. Ai nënvizoi rëndësinë e një bashkëpunimi konstruktiv mes Qeverisë dhe opozitës edhe në interes të një bashkëpunimi të suksesshëm për zhvillim.

Kryetari i delegacionit gjerman, zoti Van de Sand, përgëzoi Shqipërinë për progresin e shënuar politik dhe ekonomik, që mundësoi nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian në qershor të vitit 2006. Gjermania dhe Bashkimi Evropian shprehin që Shqipëria të vazhdojë të dëshmojë edhe në të ardhmen shenja të dukshme të realizimit të deklaratave mbi qeverisjen e mirë, shtetin ligjor dhe luftën kundër korrupsionit. Ai deklaroi gatishmërinë për të mbështetur më tej Shqipërinë në këtë rrugë si në planin bilateral, ashtu edhe në atë multilateral. Për shkak të fondeve publike në rënie në të ardhmen, projektet e PPP marrin një rëndësi të veçantë. Për fat të keq, projekti PPP në Elbasan ka kaluar në faza me vështirësi serioze, zgjidhja e të cilave tanimë është në dorën e palës shqiptare. Ai theksoi rëndësinë e arritjes së qëndrueshmërisë financiare në projekte të sektorëve të energjisë dhe ujit/kanalizimeve. Në të dy sektorët ekziston nevoja e përpjekjeve më intensive nga ana e palës shqiptare. Në mënyrë të veçantë, Ndërmarrja Energjetike KESH duhet të rikthehet në kushte ekonomike të shëndetshme.

Duke iu referuar objektivave për zhvillim të mijëvjeçarit, drejtuesi i delegacionit theksoi rëndësinë e luftës ndaj varfërisë absolute dhe relative dhe paralajmëroi për rrezikun e një zhvillimi ekonomik në dëm të mjedisit.

Zoti Van de Sand përshëndeti raportin konstruktiv të Shqipërisë me fqinjët e tij duke sjellë si shembull EUREGIO-n në zonën e liqenit të Ohrit dhe të Prespës, si dhe bisedimet e suksesshme me Malin e Zi mbi linjën 400 kv Tiranë-Podgoricë si pjesë e rrjetit rajonal të energjisë. Të dyja këto janë shembull i një bashkëpunimi të mirë rajonal, që është edhe një ndër tre qëllimet më kryesore të Paktit të Stabilitetit. Përmes rrjetit të energjisë nga Vjena në Athinë, si dhe përmes EUREGIO-s Shqipëria do t'i afrohet edhe më shumë qëllimit tjetër të madh, përafrimit me BE-në.

Në mbyllje ai theksoi që përgatitja dhe zhvillimi i zgjedhjeve të ardhshme lokale do të jetë një gur prove dhe dëshmi për progresin e mëtejshëm në kuadër të procesit të transformimit. Në Bashkimin Evropian do të ndiqet me vëmendje progresi në procesin e demokratizimit dhe në arritjen e “pronësisë së përbashkët evropiane”.

Kryetari i delegacionit gjerman deklaroi që në kuadrin e buxhetit federal 2006 janë miratuar burime financiare të tjera në një shumë të përgjithshme prej 13.5 milionë euro për projektet e bashkëpunimit financiar dhe teknik. Po kështu janë riprogramuar edhe 5.75 milionë euro nga fondet e BE-së të viteve 1998 dhe 2002. Këtyre u shtohen edhe burimet financiare të KfW-së në shumën deri në 18 milionë euro si shtesë për mjetet financiare të BF-së për sektorin energjetik.

1. Çështje të përgjithshme

Pala gjermane theksoi problemet që vazhdojnë të ekzistojnë në lidhje me përfundimin e marrëveshjes qeveritare dhe solli në vëmendje rezultatet e arritura me konsensus në bisedën e punës së 15 shkurtit 2006, të cilat janë përpiluar me shkrim në notën verbale nr.47/06 të Ambasadës së Republikës Federale Gjermane në Tiranë të datës 17 shkurt 2006. Ajo theksoi që rezultatet, sipas mendimit të saj, nuk janë të negociueshme. Kështu, për shkak të konsideratave parimore në tekstin e marrëveshjes qeveritare, nuk mund të pranohet:

- a) përcaktimi i masave shoqëruese;
- b) specifikimi i projekteve të tjera rezervë; dhe as
- c) referimi i barasvlershëm në të drejtën shqiptare.

Pala gjermane i kërkoi përsëri palës shqiptare që në të ardhmen të heqë dorë nga propozimet për ndryshimin e kësaj përmbytjeje, në mënyrë që kohëzgjatja e procedurës të mund të shkurtohej më tej.

Zyra e KfW-së në Tiranë

Për intensifikimin e bashkëpunimit të zhvillimit gjermano-shqiptar, zyra e KfW-së në Tiranë, që për momentin është nën drejtimin e zotit Dr.Christian Luetke Woestmann, të regjistrohet me status zyrtar. Pala shqiptare premtoi ta mbështesë regjistrimin.

Zyra e GTZ-së në Tiranë

Duke filluar nga data 1.7.2006, përfaqësimin e zyrës së GTZ-së në Shqipëri e ka marrë përsipër zoti Ismail Beka. Zoti Beka është pasardhësi i zonjës Anula Guda në këtë funksion, e cila ka ndërmarrë detyra të tjera në kuadër të Programit të GTZ-së.

2. Prioritetet e bashkëpunimit

Të dyja Palët mbështesin temat kryesore të bashkëpunimit dypalësh: furnizimi me ujë të pijshëm/kanalizimet (heqja e mbeturinave), energjia dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, të cilat nëpërmjet ndikimit të tyre në shtresat e varfra do të jepnin një kontribut të veçantë në politikat e zhvillimit për luftën kundër varfërisë sipas Programit të Veprimit 2015 të Qeverisë Federale Gjermane, si dhe të Strategjisë Kombëtare për Integrimin European (Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë (SKZHSESH)).

Pala shqiptare informoi në lidhje me gjendjen e ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin European. Pala gjermane deklaroi që ajo vazhdon të ishte e gatshme të mbështeste procesin e përafrimit me Bashkimin European edhe në kuadrin e bashkëpunimit teknik dhe financiar.

3. Projekte në vazhdim ose të miratuara të bashkëpunimit financiar (BF) ose teknik (BT)

3.1 Tema “Furnizimi me ujë të pijshëm/kanalizimet”

Pala gjermane inkurajoi Qeverinë Shqiptare ta vazhdonte pa ndërprerje rrugën e nisur për reformën e menaxhimit të ujit në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Kështu pala gjermane theksoi që duke pasur parasysh përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të ndërprerë subvencionet shtetërore për sektorin e ujit, për impiantet e ujit duhet të gjenden zgjidhje transitorë, derisa tarifat e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve, që do të mbulonin plotësisht shpenzimet, të jenë të zbatueshme dhe të pranohen nga popullata.

3.1.1 Bashkëpunimi financiar (BF)

Mbështetja e ekonomisë nëpërmjet zgjerimit të infrastrukturës lokale në Elbasan

Pala gjermane po ndjek me shqetësim të madh zhvillimin e bisedimeve të Qeverisë Shqiptare dhe të bashkisë Elbasan me shoqërinë koncesionare “Berlinwasser International” (BWI) për zgjidhjen e vështirësive ekonomike të shoqërisë koncesionare pas prishjes së kontratës së koncesionit.

Pala shqiptare deklaroi se Këshilli i Ministrave do të miratojë në fund të muajit shtator vendimin për blerjen e ELBER sh.p.k. nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës.

Pala gjermane përshëndeti këtë deklaratë dhe theksoi urgjencën e marrjes së këtij vendimi për të garantuar që furnizimi me ujë i qytetit të Elbasanit të mos ndërpritet. Sipas mendimit të palës gjermane ngritja e konsiderueshme e tarifave dhe rimarrja e shoqërisë së koncesionit në programin e subvencionit nga shteti janë të domosdoshme për një aktivitet të qëndrueshëm.

Pala shqiptare siguroi se Qeveria Shqiptare po ndërmerr të gjitha masat për të zgjidhur problemet ekonomike dhe institucionale të shoqërisë së re.

Mjetet e tjera financiare në vlerën e 6 milionë euro ishin vënë në dispozicion për shoqërimin e koncesionit. Nëse këto mjete financiare nuk do të përdorreshin deri në fund të vitit 2007, do të skadonin. Pala gjermane sugjeroi një riprogramim të fondeve të mbetura, në atë masë që do të mund të siguronte efikasitetin ekonomik dhe teknike të projekteve. Për këtë qëllim gjatë konsultimeve qeveritare të ardhshme në pranverën e vitit 2007 do të gjendet një zgjidhje konsensuale.

Programi për mbrojtjen e mjedisit “Liqeni i Ohrit — kanalizimet Progradec”

Pala gjermane përshëndeti përfshirjen e palës shqiptare në projektin për mbrojtjen e liqenit të Progradecit, gjë që duket në rritjen e kontributit të vet shqiptar me 250 000 euro për kanalizimet e ujërave të bardha në Tushemisht. Planifikimi i detajuar dhe specifikimet e punëve që duhet të kryhen, u morën përsipër nga konsulenti zbatues i projektit, Konsorciumi Dahlem/Diwi. Pala gjermane iu përgjigj dëshirës së Ministrisë së Punëve Publike për të verifikuar nëse mbikëqyrja e ndërtimit mund të merrej përsipër nga konsulenti që punonte në terren.

Për të ardhur më afër objektivit të programit — mbrojtjes së liqenit të Ohrit dhe banorëve e shfrytëzuesve të tij janë të domosdoshme edhe masa të tjera në fushën e kanalizimeve, të cilat do të ngrënë shkallën e lidhjes me grumbullimin e ujërave të zeza e të bardha dhe pastrimin e tyre. Koncepti i kanalizimeve të përgatitur nga Dahlem/Diwi parashikon shumë faza, nga të cilat deri tani është realizuar vetëm njëra. Pala shqiptare dhe gjermane ranë dakord për të riprogramuar burime shtesë për zgjerimin e programit të kanalizimeve me masa të fazës së dytë në Pogradec.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet “Kruja II”

Pala gjermane i kërkoi palës shqiptare të tregonte kujdes që të sigurohej financimi i plotë i projektit, me qëllim që të mbështetet financiarisht ujësjellësi në Krujë për realizimin e masave për përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe garantimin e sigurisë së impiantit. Qëndrueshmëria financiare e tanishme e ujësjellësit të Krujës tashmë nuk është e mjaftueshme për të garantuar një aktivitet të pranueshëm dhe një

mirëmbajtje të mjaftueshme të impianteve. Funksionimi i plotë implantit dhe sigurimi i një furnizimi të vazhdueshëm të popullatës nga rrjeti mund të garantohen vetëm nëpërmjet masave shtesë të mirëmbajtjes në shumën 400 000 euro. Për financimin e këtyre masave nuk janë vënë në dispozicion burime nga BF-ja. Të dyja Palët bien dakord që kjo pjesë e pambuluar në financim duhet të plotësohet në një afat të shkurtër.

Programi i furnizimit me ujë në zonat rurale

Pala gjermane informoi që përgatitet për një program të furnizimit me ujë të zonave rurale me anë të aktivizimit të ekspertëve për identifikimin e fillimeve të mundshme të projektit kanë përparuar së tepërmi. Si hapa të parë janë planifikuar mbledhja e të dhënave, si dhe analiza e grupeve të përfituesve. Të dyja Palët ranë dakord me përfundimet e ekspertit se FSHZH-ja do të ishte zbatuesi më i përshtatshëm i projektit. Pala gjermane synon që të realizojë verifikimin e programit qysh këtë vit. Duke u bazuar në bashkëpunimin e mirë me FSHZH-në në kuadër të bashkëpunimit financiar është planifikuar aktivizimi i FSHZH-së si agjenci zbatuese për këtë program.

Programi i furnizimit me ujë “Shqipëria e Mesme (komponentët Berat Kuçovë)”

Pala gjermane informoi që është filluar me një program të zgjeruar për pakësimin e humbjeve me anë të një pakete masash urgjente. Tenderimi i këtyre masave është kryer. Është bërë propozimi për realizimin e investimeve të tjera, i cili së shpejti do të diskutohet me palën shqiptare.

Heqja e mbeturinave pjesa juglindore e Shqipërisë

Pala gjermane përshëndeti përfshirjen e komunave në rajonin e projektit për krijimin e organizatës përgjegjëse dhe për përgatitjen e mëtejshme të projektit. Ajo theksoi që aftësia për punë e organizatës përgjegjëse, mbulimi i shpenzimeve operative, zbatimi me sukses i projekteve pilot, si dhe sigurimi i financimit të plotë janë kusht paraprak për një financim të mundshëm të projektit nga BF-ja. Ajo informoi që konsulenca për një përgatitje të mëtejshme të projektit (fazë e ndërmjetme) është tenderuar dhe do të jepet në fillim të vitit 2007.

3.1.2 Bashkëpunimi teknik

Për momentin nuk ka asnjë projekt prioritar.

3.2 Prioriteti “Energjia”

3.2.1 Bashkëpunimi financiar

Linja e transmetimit 400 kv

Afati i tenderimit për furnizimet dhe kontributet e projektit mbaron më 11 shtator 2006. Pas vlerësimit të ofertave fituesi për furnizimin dhe kontributet do të zgjidhet në fillim të tremujorit të katërt të vitit 2006. Sipas planit kohor linja duhet të jetë e përfunduar para fundit të vitit 2008.

Lidhja në kohë e marrëveshjes së nënhuasë ndërmjet KESH/Shqipëri dhe EPCG/Mali i Zi para fillimit të punës është thelbësore, pasi ky është një kusht paraprak për livrimin e fondeve. Për lidhjen e kontratës dhe për mbështetjen e palës shqiptare është angazhuar një studio ligjore vendase. Financimi është i mundur deri në një shumë prej 50 000 euro nga burimet e BF-së gjermane (FSE VI). Ndërkohë është bërë gati një projekt marrëveshje. Ekziston mirëkuptimi që pala shqiptare, së bashku me EPCG/Mali i Zi të sqarojnë sa më parë që të jetë e mundur çështjet e mbetura pezull për të mënjeluar zvarritjet në realizimin e projektit.

Po kështu i një rëndësie të madhe për suksesin e projektit është përfundimi në kohë i nënstacionit Tirana II. Ky projekt i financiar nga Qeveria Italiane është miratuar, por deri tani nuk është bërë tenderimi për furnizimin dhe kontributet e projektit. Shpallja e fituesit për furnizimin dhe kontributet duhet të bëhet jo më vonë se fillimi i vitit 2007, nëse duhet të mënjanohej zvarritjet në zbatimin e projektit. Për të garantuar këtë, duhet të përgatitet sa më parë që të jetë e mundur tenderi.

Programi i sektorit të energjisë

(Mbështetja e energjive të rigjenerueshme dhe efica e energjisë)

Realizimi i deritanishëm po ecën shkëlqyeshëm nga të gjitha Palët. Kështu që pritet që pas përfundimit të afatit të tenderimit të kryhet edhe përzgjedhja e konsulentit të zbatimit dhe pranimi i emërimit të tij dhe ky i fundit të fillojë punën para fundit të vitit 2006.

Në kuadrin e projektit duhet të përpunohen edhe rekomandime të përgjithshme për ngritjen e kushteve të përgjithshme institucionale dhe rregullatore të fushës (veçanërisht në raport me çështjen e dhënies së koncesionit dhe caktimit të tarifave) për prodhimin e energjisë në mënyrë të decentralizuar.

Furnizimi me energji elektrike i jugut të Shqipërisë (Bistrica I dhe II)

Rehabilitimi i centralit elektrik të Bistricës I dhe ndërtimi i ri i linjës së transmetimit 110 kv nga Bistrica I për në Sarandë, si dhe ndërtimi i nënstacionit në Sarandë u përfunduan në pjesën më të madhe në vitin 2005. Inaugurimi zyrtar i centralit të rehabilituar Bistrica I u bë më 23.3.2006 në prani të Kryeministrit të Shqipërisë dhe të ambasadorit gjerman.

Punimet për fazën e dytë të projektit filluan më 19.6.2006. Rehabilitimi i centralit Bistrica II, si dhe përmirësime dhe ndërtime të tjera të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes në rajon duhet të përfundojnë

brenda 18 muajsh. Me këto furnizimi me energji elektrike në këtë pjesë të Shqipërisë do të përmirësohet së tepërmi.

3.2.3 Bashkëpunimi teknik

Për momentin nuk ka projekte prioritare.

3.3 Prioriteti “Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm”

3.3.1 Bashkëpunimi financiar

Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla në zonat rurale dhe urbane

Në kuadrin e zgjerimit të programit ekzistues të SME-ve në të ardhmen, përveç zonave të qyteteve, shërbimet financiare duhet t’iu ofrohen edhe zonave rurale. Për këtë qëllim nga Qeveria Federale janë vënë në dispozicion 6 milionë euro (si dhe 210 000 euro për masat shoqëruese).

Si këst i parë u vunë në dispozicion (në vitin 1998) 2.6 milionë euro (si dhe 210 000 euro për masat shoqëruese) nga burimet e fondit të vitit 1998. U nënshkruan me fondacionin FEFAD kontratat përkatëse të huasë dhe nënhuasë. Por vazhdon të mungojë ratifikimi i marrëveshjes qeveritare nga pala shqiptare. Pa këtë nuk mund të fillohet me zbatimin e projektit. Nëse ratifikimi nuk bëhet në muajt në vazhdim, burimet financiare skadojnë në fund të vitit 2006 dhe nuk do të jenë më në dispozicion.

Po kështu nga burimet financiare të fondit të vitit 2004 u vunë në dispozicion 3.4 milionë euro si këst i dytë.

Të dyja Palët ranë dakord që të dyja marrëveshjet dhe kontratat përkatëse do të nënshkruhen pa vonesë.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Fondin Europian për Europën Juglindore (EFSE). Të dyja Palët përsëriten mundësinë e pjesëmarrjes së Shqipërisë në EFSE dhe mbështesin si hap të parë përdorimin e kapitalit të fondacionit FEFAD si kapital themelor për pjesëmarrjen në EFSE.

3.3.2 Bashkëpunimi Teknik

Fondi për studime dhe ekspertë (FSE)

Nga fondi për studime dhe ekspertë i vitit 2005 deri më 1.8.2006 nuk ishin përdorur rreth 300 000 euro. Ato qëndrojnë në dispozicion për projekte të tjera të vogla këshillimore.

Këshillimi i Shoqatës Shqiptare të Ujit (FSE)

Faza e dytë u dorëzua për zbatim në korrik 2005 dhe duket se do të vazhdojë deri në fund të korrikut 2007. Ky aktivitet është pjesë e projekteve të shumta të BF-së në sektorin e ujit.

Nxitja e iniciativave për mbrojtjen e konsumatorit (FSE)

Për shkak të rezervave në lidhje me funksionimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm me Shoqatën Shqiptare të Konsumatorëve (Albanian Consumer’s Association) në një fazë paraprake u realizuan “Masa për forcimin e besimit”. Pas afërsisht një vit bashkëpunimi është vendosur një marrëdhënie besimi dhe afatgjatë bashkëpunimi.

Bashkëpunimi ndërkufitar — Rajoni Euro /Liqeni i Prespës (FSE)

Projekti ndodhet në fazën e përfundimit, i cili ka si afat gushtin e vitit 2007. Pala shqiptare ka vënë në dispozicion burimet e veta në masën 13 000 euro.

Modernizimi i regjistrit të pasurive të paluajtshme / Kadastra (FSE)

Projekti është në fazën e përgatitjes. Në qershor të vitit 2006 në Tiranë erdhi një mision ekspertësh për të përpiluar një plan të hollësishëm.

Këshillim për përafrimin me Bashkimin Europian

Faza e parë e projektit mund të zgjatet deri në fund të vitit 2006 me burimet e vëna ekzistuese financiare. Për fazën e re duhet të arrihet marrëveshje.

Bashkimi në një program i projekteve me orientim ekonomik

Prioriteti i bashkëpunimit teknik dypalësh është nxitja e përbashkët e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Pala gjermane informoi që për një shfrytëzim më të mirë dhe për përfundimin e shtysave të reja, projektet me orientim ekonomik duhet të përfshihen nën menaxhimin e njësuar të një programi. Këtu bëhet fjalë veçanërisht për projektet e mëposhtme:

- mbështetje e ekonomisë dhe e punësimit në zonat ekonomikisht më pak të zhvilluara në veri të Shqipërisë;

- mbështetje e ekonomisë private me prioritet rajonin Korçë/Pogradec (faza II);

- forcimi i ekonomisë në rajonet Korçë/Pogradec dhe në rajonet veriore të Shqipërisë nëpërmjet kualifikimit profesional;

- mbështetja e Ministrisë së Ekonomisë/Tregtisë dhe Energjetikës;

- mbështetje e ekonomisë në nivel lokal në Tiranë;

- mbështetja e agjencisë shqiptare ALBINVEST për nxitjen e investimeve në fushën e investimeve të drejtpërdrejta të huaja; si dhe

- shkëmbimi profesional i menaxherëve shqiptarë me ekonominë gjermane dhe forcimi i shoqatave të sipërmarrësve.

Të dyja Palët ranë dakord që këta komponentë, duke filluar nga viti 2007, të përfshihen në një projekt të

integruar të nxitjes së ekonomisë dhe punësimit për përmirësimin e ndikimit dhe të efikasitetit ekonomik.

3.4. Të ndryshme

Bashkëpunimi financiar

Planifikimi financiar (NESMARK)

Me përfundimin e marrëveshjes financiare dhe asaj të projektit në fillim të këtij viti është plotësuar një parakusht i rëndësishëm për vazhdimin e mëtejshëm të projektit. Megjithatë pala gjermane konstaton me shqetësim që një rregullim i ri çmimesh i prezantuar në fillim të tremujorit të parë të vitit 2005 nga Ministria e Shëndetësisë ka shkaktuar humbje të mëdha në xhiron e subjektit të projektit NESMARK dhe ka rrezikuar së tepërmi qëndrueshmërinë e aktiviteteve sociale të marketingut. Pala shqiptare informoi se është marrë një vendim i Këshillit të Ministrave, i cili rregullon në një formë të pranueshme nga NESMARK aspektet kryesore të rregullimit të çmimit.

Rezervati biosferik ndërkuftar i Prespës

Në kuadrin e programit të hapur “Rezervati biosferik ndërkuftar i Prespës” në Shqipëri është parashikuar mbështetja e parkut kombëtar “Prespa”. Verifikimi i programit nxori që është e nevojshme zgjatja e periudhës së zbatimit të komponentëve shqiptarë të programit nga 3 në 5 vjet, pasi është i domosdoshëm ndryshimi rrënjësor i sjelljes së popullatës, me qëllim që të sigurohet ndikimi i programit në mënyrë të qëndrueshme.

4. Premtime të reja dhe riprogramimet

Për burimet e reja në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim me Shqipërinë në kontekstin e buxhetit federal 2006 për projekte në bashkëpunimin teknik dhe financiar vihen në dispozicion fonde deri në masën 13.5 milionë euro. Po kështu riprogramohen edhe 5 milionë euro nga fondet e BF-së të vitit 2002, si dhe burimet e mbetura në masën 0.75 milion euro nga viti 1998.

4.1.1 Premtime të reja BF

Volumi i përgjithshëm i deritanishëm i bashkëpunimit financiar me Shqipërinë është afërsisht 278 milionë euro. Për vitin 2006 Republika Federale Gjermane i siguron Republikës së Shqipërisë burimet e tjera në shumën e përgjithshme prej 11 milionë euro.

Me këto duhet të realizohen projektet e mëposhtme:

Projekte të reja

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë nepërmjet

linjës unazë në jug të Shqipërisë 10,75 milionë euro.

(hua)

(Projekti parashikon zgjerimin e rrjetit të energjisë elektrike 110 kv në juglindje dhe jugperëndim të Shqipërisë.)

Shtesë fondesh:

Rezervati biosferik i Prespës

0.25 milionë euro

(Kontribut financiar)

Huaja jepet për një periudhë 40-vjeçare me një përqindje interesi prej 0,75% në vit dhe 10 vite pa detyrim shlyerje.

4.1.2 Riprogramimet e BF-së

Të dyja delegacionet ranë dakord për të riprogramuar nga burimet e vitit 2002 5.0 milionë euro (hua) nga programi i planifikuar i ujit në Bajram Curr në projektin e ri “Kanalizimi i ujërave të zeza Pogradec”.

Po kështu duhet të riprogramohen burimet e mbetura në masën 0.75 milionë euro nga fondet e vitit 1998 (shuma e financimit) për shtesën e fondeve të “Rezervatit biosferik të Prespës”. Parakusht për këtë është konkretizimi i këtyre mjeteve në një kontratë financimi brenda vitit 2006. Nëse këto burime të mbetura nuk janë përcaktuar me kontratë deri në atë moment, ato skadojnë.

4.1.3 Kombinimi i mjeteve financiare të tregut (BF)

Burimet e vëna në dispozicion nga Qeveria Federale mund të kombinohen me burime financiare tregu shtesë të KfW-së.

Për garantimin e financimit të plotë të projektit përmirësimi i efikasitetit të energjisë nëpërmjet linjës unazë në Shqipërinë jugore në vlerën e rreth 30 milionë eurove, ekziston mundësia e plotësimit të burimeve të BF-së nga mjete financiare të tregut të KfW-së deri në shumën 18 milionë euro.

4.1.4 Kreditë mbështetëse në kuadër të BF-së

Në plotësim të instrumenteve financiare ekzistuese të BF, KfW-ja mund të japë për llogari të saj kredi mbështetëse në kuadër të BF-së për projekte të rëndësishme nga pikëpamja e politikave të zhvillimit si për institucionet apo ndërmarrjen shtetërore, ashtu edhe ato private. KfW-ja vepron kështu si i ngarkuar i veçantë i Qeverisë së Republikës Federale Gjermane. Duke u nisur nga karakteri i projekteve që financohen, Shqipëria është e vetëdijshme se para dhënies së kredisë mbështetëse është e domosdoshme dhënia në kohë dhe masë të

plotë e valutave lehtësisht të konvertueshme për shlyerjen pa asnjë pengesë të detyrimit (transferim i valutës) kundrejt KfW-së dhe përpiqet që këtë kërkesë ta përmbushë gjithmonë në kohë. Në këtë kontekst Shqipëria garanton që nuk do ta trajtojë KfW-në në mënyrë të disfavorshme në raport me institucionet financiare shumëpalëshe.

4.2 Projekte të reja të BT-së

Volumi i përgjithshëm i deritanishëm i bashkëpunimit teknik me Republikën e Shqipërisë është afërsisht 93 milionë euro. Për vitin 2006 Republika Federale e Gjermanisë i siguron Republikës së Shqipërisë një subvencion tjetër për realizimin e projekteve të bashkëpunimit teknik në masën 2.5 milionë euro.

Me këtë duhet të realizohen projektet e reja të mëposhtme:

Mbështetje e integruar e ekonomisë dhe punësimit 1.0 milionë euro

Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet formimit profesional 1.0 milionë euro

(Qëllimi i këtij projekti është realizimi i një formimi profesional të orientuar nga tregu dhe praktika nëpërmjet studimit të specialitetëve të një niveli të lartë (akademi profesionale).

Shtesë e fondit për studime dhe ekspertë (FSE) 0.5 milionë ruro

Në FSE nuk janë përdorur fondet e mbetura prej afërsisht 0.3 milionë euro. Së bashku me burimet e reja, fondi bëhet mbi 0.8 milion euro, që mund të përdoret për masat e mëposhtme:

- Këshillim i Shoqatës Shqiptare të Ujit (faza tjetër);

- Bashkërendimi i bashkëpunimit teknik.

Fondet Rajonale

Krahas kësaj vihen në dispozicion edhe fondet e mëposhtme në kuadrin e bashkëpunimit teknik, që po kështu mund të përdoren nga Shqipëria:

- Fond për këshillim në fushën e ekonomisë së huaj 2.15 milionë euro

- Fond për këshillim ligjor 2.0 milionë euro

- Fond për modernizimin e shërbimeve komunale 2.0 milionë euro

- Fond për studime dhe ekspertë 1.0 milionë euro.

5. Bashkëpunimi i ardhshëm

Do të zhvillohet në sektorët kyç të rënë dakord.

6. Forma të tjera të bashkëpunimit

6.1 Ekspertët e integruar

Delegacioni gjerman theksoi që Qeveria e Republikës Federale Gjermane është e gatshme të ndihmojë Shqipërinë në përpjekjet e saj për të plotësuar nevojat për specialistë në sferat e rëndësishme të politikave ekonomike, të cilat nuk ka ekspertë vendas. Qeveria e Republikës Federale Gjermane mund të rekrutojë specialistët e përshtatshëm në tregun gjerman të punës dhe t'u garantojë atyre, brenda mundësive financiare të saj, shtesat e pagave.

Për momentin në Shqipëri janë integruar 2 ekspertë të integruar në prioritetin "Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik".

Institucionet publike ose private shqiptare mund t'i drejtojnë kërkesat e tyre për ekspertë të integruar nëpërmjet Ambasadës Gjermane në Tiranë "Qendrës për Migrim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (CIM)", Barckhausstr. 16, D-60325 Frankfurt/M. CIM është i gatshëm që të marrë edhe kërkesa të tjera nga partnerët shqiptarë dhe t'i konsiderojë pozitivisht ato.

6.2 Formimi politiko-shoqëror

Delegacioni gjerman theksoi që për momentin fondacioni "Konrad Adenauer", fondacioni "Friedrich-Ebert" dhe fondacioni "Hans-Seidel" (të gjithë me seli në Sofie) vazhdojnë të veprojnë në Shqipëri me mbështetjen financiare të Republikës Federale. Përveç kësaj Instituti për Bashkëpunimin Ndërkombëtar i Shoqatës Gjermane të Shkollave të Larta zbaton masa mbështetëse për arsimimin e të rriturve.

6.3 Puna e qendrave kishtare

Kryetari i delegacionit gjerman informoi që Qeveria e Republikës Federale Gjermane mbështet financiarisht edhe bashkëpunimin për zhvillim, që livojnë strukturat kishtare gjermane në Shqipëri.

6.4 Këshillimet nga shërbimi i ekspertëve në pension (SES- Senior-Experten Service)

Pala gjermane informoi në lidhje me aktivitetin SES të nxitur nga Qeveria Federale, që ka filluar në Shqipëri qysh të vitin 1991 me gjithsej 40. Prioritet i këshillimit nga ekspertët që janë larguar nga jeta aktive profesionale ishte mënjanimi i problemeve akute teknike apo në menaxhimin e sipërmarrjeve të vogla apo të mesme.

6.5 InWEnt

InWEnt mbështet Shqipërinë me anë të dialogut ndërkufitar dhe trajnimit për realizimin e reformave ekonomike dhe shoqërore, përafrimin me strukturat e BE-së dhe ndërtimin e një ekonomie tregu. Aktivitetet InWEnt përqendrohen para së gjithash në temat e teknologjive inovative të ambientit, kualifikimit profesional të orientuar nga punësimi, forcimit të organizatave dhe shoqatave ekonomike, nxitjes ekonomike në nivel komunal dhe rajonal, si dhe ndërtimit të strukturave dhe institucioneve në zonat rurale. Për vitet në vazhdim në Shqipëri do të synohet bashkimi i prioritetëve sektoriale për nxitjen e një zhvillimi ekonomik të integruar rajonal.

7. Kushte për zbatimin e projekteve

Të dyja delegacionet bien dakord që të gjitha kontributet e caktuara në këtë deklaratë (nën pikën 4) nga pala gjermane do të jepen vetëm atëherë, kur:

- Qeveria e Republikës Federale Gjermane të ketë marrë një vendim pozitiv, bazuar mbi verifikimin e projekteve/programeve nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ) GmbH dhe/ose një organizatë tjetër e ngarkuar me këtë detyrë;

- të jetë siguruar i gjithë financimi i projektit / programit;

- të kenë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare që duhet të përfundohen (Marrëveshjet e projektit, d.m.th. këmbimi i notave).

8. Klauzolë

Pala gjermane theksoi në mënyrë të veçantë që fondet e bashkëpunimit teknik (shifra 4) skadojnë pa u zëvendësuar brenda 8 vjetësh pas vitit të dhënies nëse nuk është e lidhur marrëveshja e zbatimit, d.m.th., këmbimi i notave për fondet e vitit 2006 afati skadon në datën 31.12.2014.

Nëse një apo disa nga projektet e përmendura nuk zbatohet apo zbatohet pjesërisht, në marrëveshje ndërmjet dy qeverive, ai mund të zëvendësohet me një ose disa projekte të tjera.

9. Deklaratë

Pala gjermane përshëndeti masat e marra nga Qeveria Shqiptare për luftën kundër korrupsionit, si dhe për vazhdimin dhe thellimin e saj në të gjitha fushat.

Të dyja qeveritë do të bashkëpunojnë ngushtë për të garantuar transparencë, përgjegjshmëri dhe integritet në përdorimin e financave publike dhe mundësisht t'i përjashtojnë mundësitë ekzistuese të praktikave korruptive në bashkëpunimin e tyre për zhvillimin.

Qeveria Gjermane përshëndeti masat e Qeverisë Shqiptare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Ratifikimi i protokollit të Palermos, miratimi i legjislacionit të gjerë kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ngritja e zyrës së koordinatorit kombëtar, si dhe plani kombëtar i veprimit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar si në kuadrin e Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore, ashtu edhe në iniciativat e tjera rajonale shihen si hapat e parë të rëndësishëm për të luftuar si objektiv trafikimin e qenieve njerëzore dhe për të garantuar mbrojtjen e viktimës brenda standardeve të të drejtave të njeriut. Qeveria Gjermane shpreson që zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore do të vazhdojë të zbatohet me vendosmëri.

Të dyja delegacionet ranë dakord që konsultimet dhe bisedimet e tjera qeveritare të zhvillohen në Tiranë në vitin 2007. Datat do të caktohen më vonë. Ky protokoll është hartuar në gjuhët gjermane dhe shqipe.

Ky protokoll hyn në fuqi pasi pala shqiptare të vërë në dijeni palën gjermane me anë të një note verbale lidhur me përfundimin e procedurave përkatëse ligjore dhe miratimin e tij.

Tiranë, 12 shtator 2006

PËR DELEGACIONIN E QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE GJERMANE

Dr.Clemens Van de Sand

PËR DELEGACIONIN E KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Enno Bozdo

BASHKËPUNIMI EKONOMIK GJERMANO-SHQIPTAR

Projektet 2006 (në milionë euro)

Fushat prioritare të bashkëpunimit	FC			TC
	Projektet	Riprogramimi i fondeve	Burimet e tregut	Projekt
I.Uji dhe ujërat e bardha				
Kanalizimet (ujërat e bardha)		5.0		
II.Energjia	10.75		Af.18.0	
III.Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik				
Nxjtja e zhvillimit të integruar ekonomik dhe				1.0

punësimit				
Zhvillimi i qëndrueshm ekonomik nëpërmjet trajnimit profesional				1.0
Rritja e fondit të studimeve dhe specialistëve				0.5
IV.Të tjera				
Liqeni i biodiversitetit i Prespës				
Shuma	11	5.75	Af.18.0	2.5

Shuma e përgjithshme

af.37.25

VENDIM
Nr.710, datë 18.10.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për bashkëpunim në fushën e energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS GREKE, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ENERGJISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Greke (këtu individualisht quhen “Pala” dhe bashkërisht Palët):

duke sjellë ndër mend miqësinë, bashkëpunimin, fqinjësinë e mirë dhe Marrëveshjen e Sigurisë të nënshkruar më 21 mars 1996;

duke sjellë ndër mend bashkëpunimin nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në Komunitetin e Energjisë;

duke sjellë ndër mend bashkëpunimin e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në BSEC;

duke theksuar se bashkëpunimi do të mbështetet kurdoherë mbi baza respekti dhe respektimin e parimeve dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare;

duke synuar shtrirjen e bashkëpunimit të tyre në sektorin e energjisë, me qëllim rritjen e bashkëpunimit në sektorët e naftës, gazit natyror dhe energjisë elektrike;

duke njohur vendimin e Bashkimit Europian nr.1229/2003/EC për zhvillimin e rrjeteve transeuropiane të energjisë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është ngritja e kuadrit për bazën e bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e naftës, gazit natyror dhe energjisë elektrike.

Neni 2

Palët do të vlerësojnë dhe njohin mundësinë e transferimit dhe shitjes, nëpërmjet tubacioneve, të gazit natyror nga Greqia në Shqipëri dhe anasjelltas dhe do të studiojnë kushtet përkatëse.

Neni 3

Palët do të shkëmbejnë informacionin e duhur që mund të jetë me interes për to dhe mund t'i ndihmojë ato për të marrë vendimet në lidhje me objektivat e mësipërme.

Neni 4

Palët do të themelojnë një komitet të përbashkët të përbërë nga përfaqësues të të dyja Palëve, me qëllim që të shqyrtojnë objektivat e përcaktuara në nenet 2 dhe 3. Komiteti i përbashkët do të mbledhet në Athinë ose në Tiranë. Për vendin dhe datën e takimeve të komitetit të përbashkët do të bihet dakord nga të dyja Palët nëpërmjet kanaleve diplomatike. Takimi i parë i komitetit të përbashkët do të zhvillohet brenda 2 (dy) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Komiteti i përbashkët do t'u paraqesë përfundimet e studimit të tij autoriteteve përkatëse për të vendosur mbi to.

Neni 5

Marrëveshja do të jetë e vlefshme për një periudhë prej pesëmbëdhjetë (15) vjetësh, duke filluar nga data e hyrjes së saj në fuqi. Marrëveshja shtyhet automatikisht për një periudhë tjetër pesë (5) vjeçare, nëse njëra prej Palëve nuk njofton tjetrën me shkrim të paktën gjashtë (6) muaj përpara datës fillestare të skadimit ose çdo periudhe të mëpasshme të vlefshmërisë, në lidhje me synimin e saj për ta përfunduar këtë Marrëveshje.

Neni 6

Marrëveshja hyn në fuqi me marrjen e njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, nëpërmjet të cilit Palët informojnë njëra-tjetrën në lidhje me përfundimin e procedurave të tyre të brendshme përkatëse që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Athinë, më 13 shtator 2006, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, greke dhe angleze. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Genc Ruli
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS GREKE
Dimitris Sioufas
MINISTËR I ZHVILLIMIT

VENDIM **Nr.712, datë 18.10.2006**

PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, KOMPETENCAT DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT AD-HOC TË LOJËRAVE TË FATIT, KAZINOVE DHE HIPODROMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e komitetit të lojërave të fatit, si një strukturë *ad-hoc*, pranë ministrit përgjegjës për ekonominë, për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e lejeve për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet.

2. Kompetencat e këtij komiteti janë:

a) Shqyrton kërkesat e subjekteve të ndryshme, për licencimin në fushën e lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve, dhe kërkesat e organeve të qeverisjes vendore, sipas pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, dhe ia paraqet për miratim përfundimtar

ministrit përgjegjës për ekonominë.

b) I propozon për miratim ministrit përgjegjës për ekonominë standardet dhe format e biletave të lojërave të fatit, pasi ka marrë parapakisht edhe mendimin e organizatorit.

c) Merr masa, në bashkëpunim me subjektet e licencuara, për shtypjen e biletave, si dhe kontrollon e mbikëqyr këtë proces, sidomos shpërndarjen e biletave subjekteve të licencuara, duke bërë regjistrimet përkatëse për secilën prej tyre.

ç) U dërgon organeve të qeverisjes vendore dokumentin e miratimit paraprak të lejeve për ushtrimin e veprimtarive të lojërave të fatit, ku përcaktohen edhe kompetencat e tyre.

d) I propozon ministrit përgjegjës për ekonominë heqjen e lejes për organizatorin e lojës së fatit, kazinosë apo hipodromit, kur vëren shkelje të dispozitave, ligjore apo nënligjore, në fuqi, që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë së subjektit apo shkelje të kushteve të përcaktuara në leje.

dh) Shqyrton kërkesat e subjekteve për ripërtëritjen e lejeve për lojërat e fatit dhe ia paraqet, për miratim, ministrit përgjegjës për ekonominë.

e) U propozon ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ministrit përgjegjës për rendin publik numrin e kazinove, që mund të hapen në një zonë të caktuar.

ë) Merr masa, në bashkëpunim me organizatorin e kazinosë dhe ministrinë përgjegjëse për rendin publik, për përcaktimin e sigurimit të kazinosë dhe të kontrollit të pjesëmarrësve në lojë.

f) I kërkon, në bashkëpunim me personat e autorizuar nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe organi i kontrollit teknik, organizatorit të subjektit vënien në dispozicion të çdo lloj dokumentacioni apo të dhëne të nevojshme, për të ushtruar kontroll mbi to apo për të mbikëqyrur veprimtarinë.

g) I propozon ministrit përgjegjës për ekonominë shfuqizimin e lejes së dhënë për lojërat e fatit apo ndërprerjen, pa paralajmërim, të procedurave të dhënies së lejes, në rast se leja apo procedurat e dhënies së saj janë në kundërshtim a cenojnë interesin e përgjithshëm.

gj) I propozon ministrit përgjegjës për ekonominë, pas shqyrtimit të projekteve të paraqitura nga organizatori, miratimin e rregulloreve për secilën prej lojërave të fatit, që luhen në kazino dhe hipodrom.

h) Njofton zyrtarisht organet tatimore për të gjitha subjektet e licencuara për lojëra fati, brenda 5 ditëve nga marrja e lejes për ushtrimin e këtyre veprimtarive. Gjithashtu, vë në dispozicion të organeve tatimore, sipas kërkesës së tyre, të gjithë dokumentacionin, që zotëron për organizatorët dhe veprimtarinë e tyre.

3. Komiteti i lojërave të fatit ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë:

a) Komiteti për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e lejeve për lojëra fati apo për çdo çështje tjetër, në lidhje me këtë fushë, përbëhet, si më poshtë vijon:

- Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme
Rregullatore, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kryetar;
- Dy përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës anëtarë;
- Një përfaqësues i Ministrisë së Financave anëtar;
- Një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme anëtar.

b) Komiteti për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e lejeve për kazino dhe hipodrom apo çdo çështje tjetër, në lidhje me këtë fushë, përbëhet, si më poshtë vijon:

- Zëvendësministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës kryetar;
- Dy përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës anëtarë;
- Një përfaqësues i Ministrisë së Financave anëtar;
- Një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme,
nga sektori i luftës kundër pastrimit të parave dhe krimit ekonomik-financiar, anëtar;
- Një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë anëtar;
- Një përfaqësues i Ministrisë së Turizmit,
Kulturës, Rinisë dhe Sporteve anëtar;
- Një përfaqësues i Ministrisë së Punës,
Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta anëtar;
- Një përfaqësues i Drejtorisë së
Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimin anëtar.

4. Mbledhjet e komitetit thirren dhe drejtohen nga kryetari. Përcaktimi i rendit të ditës dhe i datës së mbledhjes vendosen nga kryetari i komitetit dhe u bëhen të ditura anëtarëve të tjerë, të paktën 3 ditë para

mbledhjes.

5. Mbledhjet e komitetit janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se $\frac{3}{4}$ e anëtarëve. Në fillim të mbledhjes, kryetari i komitetit verifikon numrin e pjesëmarrësve dhe, në mungesë të shumicës së nevojshme, vendos thirrjen e mbledhjes tjetër jo më vonë se tri ditë.

6. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve, sipas rendit të ditës, kryetari i komitetit të lojërave të fatit vendos hedhjen në votë të çështjeve, për të cilat duhet të merret vendim nga komiteti. Vendimet e komitetit merren me shumicën e votave (shumicë absolute). Në rast barazie votash, vendimtare është vota e kryetarit të komitetit.

7. Vendimet e komitetit të lojërave të fatit janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha strukturat dhe personat e ngarkuar posaçërisht nga përmbajtja e tij.

8. Vendimet e marra nga komiteti i lojërave të fatit i dërgohen Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Ministri, për shkaqe ligjore, ka të drejtë t'i kërkojë komitetit rishqyrtim të çështjes.

9. Sektori i lojërave të fatit, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, gjatë punës së komitetit, ushtron edhe funksionet e sekretariatit teknik.

10. Sekretariati teknik ka detyrë të kujdeset për shkëmbimin e informacionit, dërgimin e njoftimeve dhe përgatitjen e materialeve, që shqyrtohen në mbledhjet e komitetit, si dhe mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve.

11. Sekretariati teknik kujdeset dhe përgjigjet për administrimin e dokumentacionit të punës së komitetit të lojërave të fatit, për dërgimin e marrjen e të dhënave, të njoftimeve dhe të korrespondencës me organet e personat juridikë, për procedurën e dhënies së lejes.

12. Komiteti i lojërave të fatit, në dhënien apo vlerësimin e kërkesave, për dhënien e lejeve në fushën e lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve apo për çdo çështje tjetër, që lidhet me to, zbaton kriteret dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, dhe në vendimin nr.238, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e dhënies së lejes, për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar.

13. Vendimi nr.239, datë 19.4.2001 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e komitetit të lojërave të fatit", shfuqizohet.

14. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, të nxjerrë dhe të miratojë rregulloren e funksionimit të komitetit të lojërave të fatit.

15. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.722, datë 25.10.2006

PËR KRITERET DHE MASËN E PËRFITIMIT TË PAGËS SË PAPUNËSISË NGA
BASHKËSHORTI/JA E PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETITIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 38, pikat 1 e 2 e 55, pika 2 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 "Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit", dhe të nenit 58, pika 2 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkëshortit/es së punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit t'i jepet trajtim i veçantë financiar, sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në këtë vendim, kur për shkak të emërimit apo transferimit pa kërkesën e punonjësit të këtij shërbimi:

a) ndërron vendbanim së bashku me familjen, të vërtetuar me certifikatë familjare, për rastet e emërimit brenda vendit, ndërsa për rastet e emërimit jashtë vendit, të vërtetuar nga njësia ku punon;

b) humbet vendin e punës;

c) nuk ka mundësi punësimi në vendbanimin e ri;

ç) nuk ushtron veprimtari fitimprurëse;

d) nuk trajtohet me ndihmë ekonomike;

dh) nuk trajtohet më me pagesë papunësie.

2. Trajtimi i veçantë financiar jepet në emër të bashkëshortit/es të papunë, në qendrën e punës së

punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

3. Masa e trajtimit financiar të jetë, si më poshtë vijon:

a) 100 për qind e pagesës së papunësisë në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshorti/ja e papunë ka vjetërsi pune nga 1 deri në 10 vjet.

b) 120 për qind e pagesës së papunësisë në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshorti/ja e papunë ka vjetërsi pune mbi 10 vjet.

Trajtimi i veçantë financiar ndryshon sa herë ndryshon pagesa e papunësisë në shkallë vendi.

4. Bashkëshorti/ja e punonjësit të SHISH-it, për të fituar trajtim të veçantë financiar, duhet të paraqesë kërkesën për punë në zyrat e punës dhe një kopje të kërkesës në qendrën e punës së punonjësit të SHISH-it.

5. Në rast refuzimi, pa arsye, të vendit të punës, të ofruar nga zyra e punës, sipas profesionit dhe specialitetit, përfituesit i ndërpritet trajtimi i veçantë financiar.

6. Trajtimi i veçantë financiar përfitohet për një periudhë deri në 7 vjet.

7. Bashkëshorti/ja e punonjësit të SHISH-it, që ka përfituar sipas shkronjës "b" të pikës 3 të vendimit nr.86, datë 12.3.1992 të Ministrave "Për disa të drejta e detyrime të ushtarakëve, të cilat rrjedhin nga ligji nr.7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", do të vazhdojë të përfitojë pagesë papunësie, në masën e përfituar, në mbështetje të vendimit të sipërpërmendur edhe për 7 vjet, por jo më shumë se 15 vjet dhe jo më pak se masa e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi.

8. Bashkëshorti/ja e punonjësit të SHISH-it, që ka përfituar trajtim të veçantë financiar, e përfiton atë edhe kur:

a) punonjësi i SHISH-it nxirret në lirim, si i paaftë përgjithmonë nga ana shëndetësore, të vërtetuar me vendim të komisionit mjekësor;

b) bëhen shkurtime, në kuadër të ristrukturimit;

c) nuk mund të sistemohet në një vend tjetër pune, brenda këtij shërbimi;

ç) vdes.

Periudha e përfitimit do të zgjasë jo më shumë se ajo e përcaktuar në pikën 6, të këtij vendimi, dhe në përputhje me kriteret e vendosura në këtë vendim. Në çdo rast, trajtimi i veçantë financiar do të tërhiqet në qendrën e punës së punonjësit të SHISH-it.

9. Periudha e trajtimit të veçantë financiar, sipas këtij vendimi, njihet si vjetërsi sigurimi, për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

10. Kontributi për njohjen e kësaj periudhe sigurimi derdhet në emër të bashkëshortit/es përfitues, i llogaritur mbi pagën minimale mujore të papunësisë, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, për efekt kontributi të sigurimeve shoqërore. Ky kontribut përballohet nga SHISH-i e përfituesi dhe derdhet në fondin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

Masa e kontributit për pension pasqyrohet në listëpagesat tip, të miratuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i SHISH-it dhe nga vetë përfituesi.

12. Ngarkohen Ministria e Financave, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16.5.2005.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.723, datë 25.10.2006

PËR KRITERET DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 "Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit, për punë cilësore, angazhim dhe rezultate në punë, për

ruajtjen dhe administrimin e pronës dhe për kryerjen e detyrave me rreziqe e mundime të veçanta, t'i jepet shpërblim, në vlerë monetare, në masën deri në 2 (dy) paga mujore në vit, me urdhër të drejtorit të SHISH-it.

2. Punonjësi i SHISH-it, në trajtim me pagesë kalimtare, me pension të parakohshëm ose në pension të plotë pleqërie, i cili aktivizohet për nevoja të këtij shërbimi, për zgjidhjen e problemeve të veçanta, përfiton me urdhër të drejtorit të SHISH-it, shpërblim, në të njëjtën vlerë monetare, si punonjësi në detyrë.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Vendim i KM
nr.723, datë 25.10.2006

Për kriteret dhe masën e shpërblimit të punonjësit të Shërbimit
Informativ të
Shtetit.....

4664

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare

ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”,
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468

Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
5. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDERTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000- 2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 7.11.2006
Doli nga shtypi më 10.11.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë